



Federata Shqiptare e Futbollit

# STATUTI I FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT

Botim zyrtar, 2023

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretari Përgjithshëm:

Ilir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare në UEFA: 1954

Anëtare në FIFA: 1932

---

Realizoi botimin: “Reklama”

## PËRMBAJTJA

N E N I	Faqe
<b>PËRKUFIZIME</b> .....	<b>5</b>
<b>I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b> .....	<b>7</b>
1-11 .....	7
<b>II. ANËTARËSIA</b> .....	<b>14</b>
12-23 .....	14
<b>III. PRESIDENTI I NDERIT DHE ANËTARI I NDERIT</b> .....	<b>26</b>
24 .....	26
<b>IV. ORGANIZIMI</b> .....	<b>27</b>
25-61 .....	27
A. Asambleja e Përgjithshme .....	29
B. Komiteti Ekzekutiv .....	42
C. Presidenti .....	47
D. Sekretariati i Përgjithshëm .....	49
E. Komisionet e përhershme .....	51
F. Organet e licencimit të klubeve .....	57

<b>N E N I</b>	<b>Faqe</b>
<b>V. KOMISIONET E PAVARURA</b> .....	<b>58</b>
62-69	58
<b>VI. MASAT DISIPLINORE</b> .....	<b>64</b>
70	64
<b>VII. ARBITRAZHI</b> .....	<b>66</b>
71-72	66
<b>VIII. FINANCAT</b> .....	<b>67</b>
73-80	
<b>IX. GARAT DHE TË DREJTAT NË GARA E NË AKTIVITETE</b> .....	<b>70</b>
81-84	70
<b>X. NDESHJET DHE GARAT NDËRKOMBËTARE</b> .....	<b>73</b>
85-87	73
<b>XI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE</b> .....	<b>74</b>
88-92	74
<b>SHTOJCA A – PYETËSOR PËR KONTROLLIN E INTEGRITETIT</b> .....	<b>101</b>
<b>SHTOJCA B – RREGULLORE E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT (FSHF)</b> .....	<b>106</b>

## PËRKUFIZIMET

Termet e përdorura më poshtë do të kuptohen si vijon:

- **FSHF:** Federata Shqiptare e Futbollit.
- **Gjykata e Arbitrazhit:** Një gjykatë private e pavarur e formuar rregullisht dhe krijuar në mënyrën e duhur, në përbërje të së cilës mund të jenë 1 ose më shumë arbitra.
- **Asambleja e Përgjithshme:** organi më i lartë dhe legjislativ i FSHF-së.
- **Federata:** një shoqatë futbollit e njohur si e tillë nga FIFA dhe nga konfederata përkatëse. Ajo është anëtare e FIFA-s, përveç se nëse nga konteksti del i qartë një kuptim tjetër.
- **Futbolli:** loja/gara e kontrolluar dhe e organizuar nga FIFA, konfederatat dhe/ose FSHF në përputhje me Ligjet e Lojës.
- **CAS:** Gjykata e Arbitrazhit për Sportin, me seli në Lozanë (Zvicër).
- **Klubi:** anëtar i FSHF-së, ose anëtar i një lige të njohur nga FSHF që ka të paktën një skuadër në një garë të organizuar nga FSHF.
- **Konfederata:** një grup shoqatash të njohura nga FIFA, të cilat i përkasin të njëjtit kontinent (ose një rajoni gjeografik të ngjashëm).
- **Delegat:** person fizik që përfaqëson në mënyrë të vlefshme një anëtar me anëtarësi të drejtpërdrejtë në Asambleshën e Përgjithshme.
- **Komitete Ekzekutiv:** organi ekzekutiv, strategjik dhe mbikëqyrës i FSHF-së.
- **FIFA:** Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Futbollit.
- **Shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin:** d.m.th. subjekte që përfshijnë dhe përfaqësojnë individë që praktikojnë profesione të lidhura me futbollin, ose klube për kategori specifike të futbollistëve që lidhen me moshën, gjininë ose llojet specifike të futbollit. Lista e plotë e shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin jepet në nenin 13 (2) (c).

- **Ligjet e Lojës:** ligjet e Federatës së Futbollit të nxjerra nga IFAB në përputhje me dispozitat përkatëse të statuteve të FIFA-s.
- **Liga:** një organizatë që është në varësi të një federate.
- **Anëtar:** person juridik që është pranuar me anëtarësim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të FSHF-së nga Asambleja e Përgjithshme.
- **Anëtar i drejtpërdrejtë:** person juridik që merr pjesë drejtpërdrejtë në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së me të drejtë përfaqësimi dhe vote.
- **Anëtar i tërthortë:** person juridik që merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së përmes anëtarit të drejtpërdrejtë ku është i anëtarësuar si anëtar i drejtpërdrejtë.
- **Zyrtar:** çdo anëtar i Komitetit Ekzekutiv, anëtar i komisioneve, arbitër dhe ndihmësarbitër, trajner dhe çdo person tjetër përgjegjës për çështje teknike, mjekësore dhe administrative në FIFA, UEFA, FSHF, një ligë ose një klub, si dhe çdo person tjetër i detyruar të veprojë në përputhje me statutin e FIFA-s, UEFA-s ose FSHF-së (përveç lojtarëve dhe ndërmjetësve).
- **Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm:** gjykatat e brendshme të shtetit, të cilat trajtojnë mosmarrëveshjet juridike publike dhe private.
- **Lojtar:** futbollist i licencuar nga FSHF.
- **Shoqata rajonale:** subjekte që përfshijnë dhe përfaqësojnë klube, të cilat i përkasin një rajoni specifik gjeografik, bazuar në ndarjen rajonale të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme. Lista e plotë e shoqatave rajonale jepet në nenin 13 (2) (b).
- **IFAB:** Bordi i Shoqatës Ndërkombëtare të Futbollit (IFAB).
- **UEFA:** Bashkimi i Shoqatave Evropiane të Futbollit.

*Shënim.* Termat që u referohen personave fizikë përfshijnë të dyja gjinitë. Çdo term në njëjës vlen edhe për shumësin dhe anasjelltas.

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### PREAMBULA

Federata Shqiptare e Futbollit është themeluar më 6 qershor 1930 dhe është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Futbollit (FIFA) prej vitit 1932 dhe e Bashkimit të Shoqatave Evropiane të Futbollit (UEFA) prej vitit 1954. Federata Shqiptare e Futbollit është anëtare e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe entiteti i vetëm kompetent për të organizuar futbollin në territorin e Shqipërisë.

---

### ENI 1 FORMA JURIDIKE, SELIA DHE MARKAT

---

1. Federata Shqiptare e Futbollit është person juridik, e organizuar si shoqatë, e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të futbollit në Republikën e Shqipërisë, të cilat veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit nr. 8789, datë 27.5.2001 *“Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”*, ligjit nr. 79/2017 *“Për sportin”* dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore që drejtojnë këtë aktivitet. Ajo është themeluar me një afat të pacaktuar kohe.
2. Selia e FSHF-së ndodhet tek *“Shtëpia e Futbollit”*, Rr *“Liman Kaba”*, Nd. 5, Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë.
3. FSHF është anëtare e FIFA-s dhe e UEFA-s.
4. Emblema dhe flamuri i FSHF-së përbëhen nga Mburoja e Logos së FSHF-së e cila paraqitet me sfond në ngjyrën e kuqe të Flamurit Shqiptar. Në krye të logos është vendosur emërtimi i Federatës Shqiptare të Futbollit në formën e shkurtuar *“FSHF”*, ku menjëherë poshtë i bashkëngjitet viti i themelimit të Federatës,

1930. Në pjesën e poshtme paraqitet një top futbollit në lëvizje, i shoqëruar me shqiponjën dykrenare të stilizuar e të dukshme pas linjave të topit.
5. Vula e FSHF-së është rrethore dhe përfshin emblemën e FSHF-së.
  6. Akronimi i Federates Shqiptare të Futbollit është FSHF.
  7. Flamuri, emblema, vula dhe akronimi janë regjistruar si marka të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).

---

## **NENI 2            OBJEKTIVAT**

---

Objektivat e FSHF-së janë:

- a) Të përmirësojë vazhdimisht lojën e futbollit dhe ta promovojë, ta rregullojë dhe kontrollojë atë në të gjitha format e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në dritën e lojës së ndershme dhe vlerave të saj bashkuese, edukative, kulturore dhe humanitare, veçanërisht përmes programeve të rinisë dhe zhvillimit;
- b) Të organizojë gara futbollit në të gjitha format e njohura nga FIFA dhe UEFA duke përfshirë por pa u kufizuar tek futsalli ose futbollit në rërë, në nivel kombëtar, duke përcaktuar saktësisht, fushat e kompetencave dhe të drejtën e delegimit për ligat e ndryshme (nëse ka të tilla) që përfshihen në FSHF;
- c) Të hartojë rregullore dhe dispozita dhe të sigurojë zbatimin e tyre;
- d) Të mbrojë interesat e futbollit dhe të anëtarëve të saj, dhe të ndihmojë anëtarët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre;
- e) Të kontrollojë dhe të parandalojë çdo shkelje të statuteve, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së si dhe ligjeve të lojës, dhe të sigurojë që ato të respektohen edhe nga anëtarët, ligat, shoqatat rajonale, klubet, lojtarët, zyrtarët, agjentët dhe ndërmjetësit;



- f) Të promovojë integritetin, etikën dhe lojën e ndershme me qëllim parandalimin e të gjitha metodave ose praktikave, të tilla si korrupsioni, dopingu ose manipulimi i ndeshjeve, të cilat mund të rrezikojnë integritetin e ndeshjeve, garave, lojtarëve, zyrtarëve dhe anëtarëve ose të shkaktojnë abuzim me futbollin, futsallin ose futbollin në rërë;
- g) Të promovojë dhe të forcojë parimet dhe praktikat e qeverisjes së mirë në nivelin kombëtar dhe të inkurajojë anëtarët e saj të miratojnë parimet e qeverisjes së mirë, brenda vetë anëtarëve;
- h) Të promovojë zhvillimin e futbollit të femrave dhe pjesëmarrjen e plotë të femrave në të gjitha nivelet e qeverisjes së futbollit;
- i) Të kontrollojë dhe të mbikëqyrë të gjitha ndeshjet miqësore të futbollit të të gjitha formave të luajtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- j) Të kontrollojë dhe të mbikëqyrë futbollin, futsallin dhe futbollin në rërë, në nivel kombëtar dhe të kontrollojë dhe mbikëqyrë të gjitha format e ndeshjeve ndërkombëtare të futbollit të luajtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me statutin dhe rregulloret përkatëse të FIFA-s dhe të UEFA-s;
- k) Të administrojë marrëdhëniet sportive ndërkombëtare të lidhura me futbollin, futsallin dhe futbollin në rërë të Konfederatës me të gjithë partnerët (p.sh. FIFA-n, UEFA-n, shoqatat ose Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar);
- l) Të organizojë gara pritëse në nivele ndërkombëtare dhe nivele të tjera;
- m) Të promovojë dhe të mbështesë iniciativat e anëtarëve të saj, për rritjen e të ardhurave të tyre në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë;
- n) Të sigurojë transparencë dhe të bëjë publike aktivitetet e FSHF-së, për sa është e mundur, dhe raportet financiare vjetore të saj.

---

## **NENI 3            DETYRIMET**

---

FSHF merr përsipër:

- a) Të investojë të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i sajë për futbollin;
- b) Të respektojë në çdo kohë statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s dhe UEFA-s, Kodin e Etikës së FIFA, vendimet e CAS-it, si dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, statutin e FSHF-së dhe rregullore të tjera të detyrueshme për FSHF-në;
- c) Të luajë rol aktiv lidhur me aktivitetet sportive të FIFA-s dhe UEFA-s;
- d) Të respektojë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sportivitetit në frymën e lojës së ndershme;
- e) Të respektojë Ligjet e Lojës të miratuara nga IFAB, si dhe Ligjet e Futbollit të Rërës dhe të Minifutbollit, të nxjerra nga FIFA;
- f) Të njohë juridiksionin e CAS-it, siç specifikohet në dispozitat përkatëse të statuteve të FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së;
- g) Të administrojë punët e saj në mënyrë të pavarur dhe të sigurojë që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë dhe të parashikojë një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve të anëtarëve të organeve të FSHF-së, në veçanti një procedurë e cila është e pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim i papërshtatshëm politik;
- h) Të veprojë në përputhje me konventat e antidopingut dhe dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi;
- i) Të sigurojë që anëtarët, ligat, klubet, lojtarët, zyrtarët, ndërmjetësit dhe agentët të bien dakord, se përmes statuteve të tyre, licencës, regjistrimit ose çdo dokumenti tjetër të shkruar, do të respektojnë detyrimet e sipërpërmendura;
- j) Të komunikojë me FIFA-n dhe UEFA-n çdo ndryshim të statutit të FSHF-së përmes përkthimit, nëse është e nevojshme, në një gjuhë zyrtare të FIFA-s dhe UEFA-s.

---

**NENI 4 TË DREJTAT E NJERIUT**

---

FSHF është e angazhuar të respektojë të gjitha të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht dhe do të përpiqet të promovojë mbrojtjen e këtyre të drejtave.

---

**NENI 5 MOSDISKRIMINIMI DHE BARAZIA**

---

Diskriminimi i çdo lloji kundër një vendi, personi privat ose grupi të njerëzve për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës etnike, kombëtare ose shoqërore, gjinisë, paaftësisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose ndonjë mendimi tjetër, pasurisë, lindjes ose ndonjë tjetër statusi, orientimi seksual ose ndonjë arsye tjetër është rreptësisht i ndaluar dhe i dënueshëm me pezullim ose dëbim dhe/ose masa të tjera disiplinore.

---

**NENI 6 NEUTRALITETI DHE PAVARËSIA INSTITUCIONALE**

---

1. FSHF është neutrale lidhur me çështjet e politikës dhe të fesë.
2. Anëtarët e FSHF-së do të jenë gjithashtu neutralë lidhur me çështjet e politikës dhe fesë dhe do të sigurojnë që anëtarët e tyre të qëndrojnë neutralë në këto çështje.
3. FSHF mbetet e pavarur dhe shmang çdo formë të ndërhyrjeve të papërshtatshme politike. FSHF i menaxhon punët e saj në mënyrë të pavarur dhe sigurohet që çështjet e veta të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, si dhe çdo sjellje të autoriteteve shtetërore që në thelb dëmton dhe çënon aftësinë e FSHF për menaxhimin çështjeve të lidhura me futbollin, realizimin në mënyrën e duhur të detyrave të saj të përcaktuara në këtë Statut, organizimin e lirë dhe pa pengesa të garave nën kujdesin e saj si dhe zgjedhjen e lire dhe te pandikueshme të forumeve, komisioneve si dhe strukturave të tjera të saj.

---

**NENI 7 PROMOVIMI I MARRËDHËNIEVE MIQËSORE**

---

1. FSHF do të promovojë marrëdhënie miqësore midis anëtarëve të saj, klubeve, zyrtarëve, lojtarëve dhe shoqërisë për objektiva humanitarë.
2. FSHF do të sigurojë mjetet e nevojshme institucionale për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje të brendshme që mund të lindë midis anëtarëve, klubeve, zyrtarëve dhe lojtarëve.

---

**NENI 8 LOJTARËT**

---

1. Statusi i lojtarëve dhe dispozitat për regjistrimin e tyre do të rregullohen nga Komiteti Ekzekutiv, në përputhje me Rregulloret e FIFA-s mbi Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve.
2. Lojtarët do të regjistrohen në përputhje me rregulloret e FSHF-së.

---

**NENI 9 LIGJET E LOJËS**

---

1. FSHF dhe secili nga anëtarët e saj do të luajë futboll në përputhje me Ligjet e Lojës të nxjerra nga IFAB. Vetëm IFAB mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës.
2. FSHF dhe secili nga anëtarët e saj do të luajë minifutboll në përputhje me Ligjet e Lojës për Futsallin të nxjerra nga FIFA. Vetëm FIFA mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës për Futsallin.
3. FSHF dhe secili nga anëtarët e saj do të luajë futboll në rërë në përputhje me Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë të nxjerra nga FIFA. Vetëm FIFA mund të vendosë dhe të ndryshojë Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë.

---

**NENI 10 SJELLJA E ORGANEVE, ZYRTARËVE  
DHE E TË TJERËVE**

---

1. Të gjitha organet dhe zyrtarët e FSHF-së duhet të respektojnë statutin, rregulloret, vendimet, dhe Kodin e Etikës së FIFA-s, dispozitat etike të UEFA-s dhe të FSHF-së në aktivitetet e tyre.
2. Çdo person dhe organizatë e përfshirë në lojën e futbollit, minifutbollit dhe futbollit në rërë në territorin e Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të respektojë statutin dhe rregulloret e FIFA-s, UEFA-s, FSHF-së dhe statute të tjera sipas rastit, si edhe parimet e lojës së drejtë, të ndershme, të integritetit, sportivitetit dhe vendimet e organeve të UEFA, FIFA si dhe ato përfundimtare të CAS.

---

**NENI 11 GJUHËT ZYRTARE**

---

1. Gjuha zyrtare e FSHF-së është gjuha shqipe. Dokumentet dhe tekstet zyrtare do të shkruhen në këtë gjuhë.
2. Gjuha zyrtare në Asamblenë e Përgjithshme është gjuha shqipe.

## II. ANËTARËSIA

---

### **NENI 12 PRANIMI, PEZULLIMI DHE PËRJASHTIMI**

---

1. Vendimin për pranimin, pezullimin ose përjashtimin e një anëtari e merr Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së.
2. Pranimi bëhet nëse kandidati përmbush kërkesat e specifikuar në këtë statut. Komiteti Ekzekutiv mund të pranojë një kandidat për anëtarësim vetëm në mënyrë të përkohshme.
3. Anëtarësia në FSHF përfundon, me anë të shpërbërjes, dorëheqjes ose përjashtimit të anëtarit. Humbja e anëtarësisë nuk e çliron anëtarin nga detyrimet e tij financiare ndaj FSHF-së, ose anëtarëve të tjerë të FSHF-së, të kërkueshme deri në atë moment, por çon në humbjen e të gjitha të drejtave në lidhje me FSHF-në. Komiteti Ekzekutiv mund të ndërmarrë çdo lloj hapi për të mbështetur anëtarin, ose mund të detyrojë pasardhësin e tij të mundshëm ligjor të përmbushë të gjitha detyrimet financiare të anëtarit të larguar para pranimi.

---

### **NENI 13 ANËTARËSIA**

---

1. Anëtarësimi në FSHF është ekskluzivisht i hapur për personat juridikë të përcaktuar në bazë të ligjit *“Për sportin”*, të cilët veprojnë dhe kanë selinë e tyre të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Anëtarësimi në FSHF mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë.
2. Anëtarësia e FSHF-së përbëhet nga:
  - a) Klubet;

- b) Shoqatat rajonale:
- Shoqata Rajonale e Futbollit Tiranë;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Durrës;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Shkodër;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Elbasan;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Fier;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Korçë;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Gjirokastrë;
  - Shoqata Rajonale e Futbollit Lezhë;
- c) Shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin:
- Shoqata e Trajnerëve;
  - Shoqata e Mjekëve Sportivë;
  - Shoqata e Arbitrave.
3. Klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore, Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Parë, shoqatat rajonale dhe shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin janë anëtarë të drejtpërdrejtë në FSHF. Të gjitha klubet dhe ekipet e tjera janë anëtarë të tërthortë në FSHF.
4. Në cilësinë e anëtarëve të drejtpërdrejtë të FSHF-së mund të pranohen edhe subjektet në vijim: Bashkimi i Lojtarëve Profesionistë me kusht që të jetë anëtar i FIFPro dhe të përfaqësojë më shumë se 60% të totalit të lojtarëve profesionistë të regjistruar nga klubet që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore dhe Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Parë.
5. FSHF mban një regjistër të anëtarëve të saj. Regjistri përfshin informacionin e mëposhtëm për secilin anëtar:
- a. numrin unik të identifikimit;
  - b. formën ligjore;
  - c. përfaqësuesin ligjor;

- d. informacion shtesë, në veçanti lidhur me licencimin e klubit (p.sh. strukturën e klubit, identitetin; rezultatet), sipas vendimeve të Komitetit Ekzekutiv.

Informacioni i përditësuar i lidhur me germën “a”, “b” dhe “c” do të bëhet publik në faqen e internetit të FSHF-së.

6. Me kërkesë paraprake, FSHF konfirmon me shkrim statusin e anëtarit.

---

## **NENI 14 PRANIMI**

---

1. Çdo person juridik që dëshiron të bëhet anëtar i FSHF-së duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të FSHF-së. Sekretari i Përgjithshëm i konfirmon kandidatit paraqitjen e kërkesës.
2. Kërkesa duhet të shoqërohet detyrimisht me dokumentet e mëposhtme:
  - a. Një kopje të vlefshme të statuteve dhe rregulloreve të vërtetuara ligjërisht për zbatimin e statuteve të përmendura (nëse ka);
  - b. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të veprjë në përputhje me statutin, rregulloret dhe vendimet e FSHF-së, FIFA-s dhe UEFA-s dhe të sigurojë që këto dokumente do të respektohen gjithashtu, nga anëtarët, klubet, zyrtarët dhe lojtarët e tij/saj (nëse është e zbatueshme);
  - c. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të veprjë në përputhje me Ligjet e Lojës në fuqi, siç përcaktohet nga IFAB, si dhe Ligjet e Lojës së Futbollit në Rrë dhe Ligjet e Lojës së Minifutbollit, siç përcaktohet nga FIFA;
  - d. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do t'i drejtohet si shkallë e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme të FSHF-së) për çdo mosmarrëveshje të dimensionit kombëtar që lind ose lidhet me statutin,



rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së vetëm të një gjykate arbitrazhi të pavarur dhe të krijuar në mënyrën e duhur, e cila do të zgjidhë përfundimisht mosmarrëveshjen duke përjashtuar çdo gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, përveç se kur ndalohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

- e. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se çdo mosmarrëveshje e nivelit ndërkombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s ose të UEFA-s mund të paraqitet në shkallën e fundit në CAS, siç specifikohet në statutin e FIFA-s dhe të UEFA-s;
- f. Një deklaratë ku kandidati vërtetohet se është i regjistruar dhe ka selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- g. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se përbërja e tij ligjore garanton se ai mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë subjekt i jashtëm dhe të sigurojë që çështjet e tij të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në veçanti që ai është i pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;
- h. Një deklaratë ku shprehet se anëtarët e organeve të veta janë zgjedhur ose emëruar si rezultat i një procedure që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve, nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;
- i. Një listë të zyrtarëve, duke specifikuar ata që janë përfaqësues ligjorë, me të drejtë të lidhin marrëveshje ligjërish të detyrueshme me palë të treta;
- j. Një kopje të procesverbalit të Asamblesë së Përgjithshme të fundit ose të mbledhjes themeluese;
- k. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se ai merr përsipër të organizojë ose të marrë pjesë në ndeshje miqësore vetëm me pëlqimin paraprak të FSHF-së (nëse aplikohet)
- l. Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të luajë të

gjitha ndeshjet zyrtare pritëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç nëse vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente (nëse aplikohet).

---

## **NENI 15 KËRKESA DHE PROCEDURA E APLIKIMIT**

---

1. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon përmbushjen formale të kërkesave të parashikuara në Nenin 14 të këtij statuti dhe përgatit një raport me shkrim për Komitetin Ekzekutiv.
2. Komiteti Ekzekutiv do të shqyrtojë raportin me shkrim dhe do të vendosë nëse kërkesa për anëtarësim i plotëson të gjitha kërkesat dhe sipas rastit, Komiteti Ekzekutiv i kërkon Asamblesë së Përgjithshme të pranojë ose jo kandidatin. Kandidati mund të deklarojë arsyet e kërkesës të tij para Asamblesë së Përgjithshme.
3. Anëtari i ri do të fitojë të drejtat dhe detyrat e anëtarësisë në momentin e pranimit. Delegatët e tij kanë të drejtë të votojnë me efekt të menjëhershëm.

---

## **NENI 16 TË DREJTAT E ANËTARËVE**

---

1. Anëtarët e FSHF-së gëzojnë të drejtat e mëposhtme:
  - a) Të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të njihen më parë me rendin e ditës së çdo Asambleje të Përgjithshme, të ftohen në Mbledhjen e Asamblese se Përgjithshme në kohën e përcaktuar, të ushtrojne të drejtën për të diskutuar dhe debatuar në Asamble dhe të ushtrojnë të drejtën për të votuar. (e aplikueshme për anëtarët e drejtpërdrejtë)
  - b) Të paraqesin propozime për t'u përfshirë në rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme (e aplikueshme për anëtarët e drejtpërdrejtë);
  - c) Të propozojnë kandidatë për zgjedhje dhe/ose emërim në

- organet përkatëse të FSHF-së (e aplikueshme për anëtarët e drejtpërdrejtë);
- d) Të informohen për çështjet e FSHF-së përmes organeve të saj zyrtare dhe të informohen për vendimet e marra nga Komiteti Ekzekutiv;
  - e) Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe/ose aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FSHF-ja dhe të organizojnë kampionat pas delegimit të kësaj të drejte nga FSHF-ja dhe nën kujdesin e saj;
  - f) Të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera që burojnë nga statuti dhe në përputhje me rregulloret dhe vendimet e FSHF-së;
  - g) Të nxjerrin rregullore vetëm në lidhje me funksionin e tyre administrativ, organizimin dhe autoritetin territorial (nëse është e rëndësishme).
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të tjera në këtë statut dhe në rregulloret e zbatueshme të FSHF-së.

---

**NENI 17 DETYRIMET E ANËTARËVE**

---

1. Anëtarët e FSHF-së kanë detyrimet e mëposhtme:
  - a) Të jenë besnikë ndaj FSHF-së, që do të thotë se ata nuk duhet të veprojnë kundër interesave të saj;
  - b) Të respektojnë plotësisht statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së në çdo kohë dhe të sigurojnë që ato të respektohen edhe nga anëtarët, lojtarët dhe zyrtarët e tyre;
  - c) Të sigurojnë zgjedhjen e organeve vendimmarrëse të paktën çdo 4 vjet;
  - d) Të mbledhin organin e tyre më të lartë dhe legjislativ në intervale të rregullta, si rregull i përgjithshëm një herë në vit;

- e) Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FSHF-ja;
- f) Të paguajnë kuotat e anëtarësisë dhe të jenë të qëndrueshëm sa u takon detyrimeve të tyre financiare, siç përcaktohet në këtë statut ose në rregulloret e FSHF-së;
- g) Të respektojnë Ligjet e Lojës të përcaktuara nga IFAB, si dhe Ligjet e Lojës së Futbollit në Rërë dhe Ligjet e Lojës së Minifutbollit, të përcaktuara nga FIFA, dhe të sigurojnë që ato të respektohen gjithashtu nga anëtarët e tyre, lojtarët dhe zyrtarët përmes një dispozite posaçme në statutet e tyre;
- h) Të miratojnë një klauzolë ligjore, statutore ku të specifikohet që çdo mosmarrëveshje e nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së mund të referohet në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme brenda FSHF) vetëm në gjykatën e arbitrazhit sportiv CAS Lozanë e cila do të zgjidhë çështjen në mënyrë përfundimtare duke përjashtuar çdo gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, me përjashtim kur një gjë e tillë ndalohej shprehimisht nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë;
- i) Të miratojnë një klauzolë ligjore ku të specifikohet që çdo mosmarrëveshje e dimensionit ndërkombëtar që lind nga ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s, UEFA-s ose FSHF-së të mund të paraqitet në shkallën e fundit vetëm në CAS, siç përcaktohet në statutin e FIFA-s dhe UEFA-s, dhe FSHF-së;
- j) Të administrojnë punët e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurojnë që punët e tyre të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në përputhje me nenin 22 të këtij statuti;
- k) Të sigurojnë që organet e tyre të zgjidhen ose të emërohen në përputhje me një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve;

- l) T'i komunikojnë FSHF-së çdo ndryshim në statutin dhe rregulloret e saj, si dhe listën e zyrtarëve të saj, të cilët janë përfaqësues ligjorë me të drejtën për të lidhur marrëveshje ligjërishit të detyrueshme me palë të treta;
  - m) Të mos mbajnë asnjë marrëdhënie të natyrës sportive me subjektet që nuk njihen ose me anëtarët që janë pezulluar ose përjashtuar;
  - n) Të respektojnë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sjelljes së mirë sportive si shprehje e lojës së ndershme përmes një dispozite statutore dhe të sigurojnë që këto parime të respektohen edhe nga anëtarët e tyre përmes një dispozite të posaçme statutore;
  - o) Të respektojnë pikat e detyrueshme të specifikuara në nenin 14, paragrafi 2, të këtij statuti gjatë kohëzgjatjes së anëtarësisë së tyre;
  - p) Të administrojnë një regjistër të anëtarëve, i cili të përditësohet rregullisht;
  - q) Të ratifikojnë statute që janë në përputhje me kërkesat e këtij statuti dhe specifikisht për shoqatat rajonale, që stautet e tyre të garantojnë përfaqësim të përshtatshëm mes anëtarëve të tyre (posaçërisht ato pjesëmarrës në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Dytë, Kategorisë së Tretë dhe Kampionatin Kombëtar për Femra) kur emërojnë delegaten pjesëmarrës në Asamblenë e Përgjithshme;
  - r) Të pajtohen plotësisht me të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga statuti dhe rregulloret e tjera të FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së.
2. Anëtarët duhet të integrojnë në statutin e tyre detyrimet e përmendura më sipër, për të qenë të zbatueshme për anëtarët e tyre.
  3. Shkelja e detyrimeve të përmendura më sipër (p.sh. paragrafi 1 dhe 2) nga çdo anëtar mund të çojë në sanksionet e parashikuara në këtë statut.

4. Shkelja e paragrafit 1/“j” më sipër mund të çojë në sanksione, edhe nëse ndikimi i palës së tretë nuk ishte për faj të anëtarit përkatës. Çdo anëtar i FSHF-së është përgjegjës në raport me të, lidhur me çdo akt dhe të gjitha aktet e anëtarëve të organeve të tyre të shkaktuara nga neglizhenca ose sjellja e qëllimtë e papërshtatshme e këtyre anëtarëve.

---

## **NENI 18 PEZULLIMI**

---

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për pezullimin e një anëtari që shkel seriozisht dhe/ose në mënyrë të përsëritur detyrimet e tij si anëtar. Megjithatë, Komiteti Ekzekutiv mund të pezullojë përkohësisht një anëtar të tillë me efekt të menjëhershëm. Ky vendim merret nga Komiteti Ekzekutiv kur shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve të tij është e pranishme dhe me një shumicë prej dy të tretave të votave të vlefshme. Pezullimi zgjat deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme, përveç nëse Komiteti Ekzekutiv e ka revokuar atë ndërkohë.
2. Anëtari në fjalë ka të drejtën të dëgjohej nga Asambleja e Përgjithshme/Komiteti Ekzekutiv dhe mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit për pezullim. Përgjigja duhet t'i dërgohet anëtarëve bashkë me njoftimin për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Nenin 33 paragrafi 4 dhe nenin 35 paragrafi 4 ose Komitetit Ekzekutiv në përputhje me nenin 40 paragrafi 3.
3. Pezullimi i një anëtari nga Asambleja e Përgjithshme ose Komiteti Ekzekutiv konfirmohet në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme me praninë e shumicës (më shumë se 50%) së anëtarëve me të drejtë vote dhe me shumicën e dy të tretave të votave të hedhura. Nëse nuk konfirmohet, pezullimi revokohet automatikisht.
4. Një anëtar i pezulluar i humbet të drejtat e tij të anëtarësisë. Anëtarët e tjerë nuk mund të kenë kontakte sportive me një

anëtar të pezulluar. Komisioni i Disiplinës dhe Etikës mund të vendosë sanksione të mëtejshme.

5. Anëtarët që nuk marrin pjesë në aktivitetet sportive të FSHF-së për 2 (dy) sezone pezullohen automatikisht nga votimi në Asamblenë e Përgjithshme dhe përfaqësuesit e tyre nuk do të zgjidhen ose emërohen derisa të përmbushin detyrimet e tyre në këtë drejtim.

---

## **NENI 19 PËRJASHTIMI**

---

1. Asambleja e Përgjithshme mund ta përjashtojë një anëtar nëse:
  - a) shkel rëndë dhe në mënyrë të përsëritur statutin, direktivat dhe/ose rregulloret ose vendimet e FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së;
  - b) nuk arrin të përmbushë kërkesat e anëtarësimit të përcaktuara në këtë statut;
  - c) nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj FSHF-së;
  - d) nuk merr pjesë në aktivitetet sportive të FSHF-së për 3 (tre) sezona radhazi.
2. Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë vetëm të propozojë përjashtimin e një anëtari.
3. Anëtari në fjalë ka të drejtë të dëgjohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe gjithashtu mund t'i përgjigjet me shkrim propozimit nga Komiteti Ekzekutiv për përjashtimin e tij. Përgjigjja do t'u dërgohet anëtarëve së bashku me thirrjen zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me nenin 33, paragrafi 4 dhe nenin 35 paragrafi 4.
4. Prania e shumicës absolute (më shumë se 50%) së delegatëve që përfaqësojnë anëtarët e kualifikuar për të votuar në Asamblenë e Përgjithshme është e nevojshme në mënyrë që përjashtimi të jetë i vlefshëm, dhe mocioni për përjashtim duhet të miratohet

me shumicë prej tre të katërtave të votave të vlefshme të hedhura.

---

## **NENI 20 DORËHEQJA**

---

1. Një anëtar mund të japë dorëheqjen me efekt nga fundi i një sezoni futbollit (d.m.th. 30 Qershor). Njoftimi për dorëheqjen duhet të mbërrijë në Sekretariatit e Përgjithshëm jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të sezonit përkatës të futbollit.
2. Dorëheqja nuk është e vlefshme derisa anëtari që dëshiron të japë dorëheqjen të ketë përmbushur detyrimet e tij financiare ndaj FSHF-së dhe anëtarëve të tjerë.

---

## **NENI 21 SHPËRBËRJA**

---

1. Nëse mbaron personaliteti juridik i një anëtari, qoftë vullnetarisht ose për shkaqe ligjore, anëtarësia e tij në FSHF do të përfundojë me efekt të menjëhershëm në momentin që pushon personaliteti i tij juridik.
2. Organi ekzekutiv i anëtarit do të informojë Komitetin Ekzekutiv për fillimin e procedurës së shpërbërjes.

---

## **NENI 22 PAVARËSIA E ANËTARËVE DHE E ORGANEVE TË TJERA**

---

1. Çdo anëtar e menaxhon punën e tij në mënyrë të pavarur dhe pa ndikim të papërshtatshëm nga palët e treta.
2. Organet e anëtarëve do të zgjidhen ose emërohen. Statutet e anëtarëve duhet të parashikojnë një procedurë demokratike që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve.



3. Organet e anëtarëve që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 më sipër, edhe mbi bazë të përkohshme, nuk do të njihen nga FSHF.
4. Vendimet e miratuara nga organet që nuk janë zgjedhur ose emëruar në përputhje me paragrafin 2 më sipër nuk do të njihen nga FSHF.

---

**NENI 23      STATUSI I KLUBEVE, LIGAVE, SHOQATAVE  
RAJONALE DHE GRUPEVE TË TJERA TË KLUBEVE**

---

1. Klubet, ligat, shoqatat rajonale ose ndonjë grup tjetër i klubeve të lidhura me FSHF-në, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, do të varen dhe njihen nga FSHF. Do të ketë vetëm një kampionat kombëtar të nivelit më të lartë në territorin e FSHF-së.
2. Ky statut përcakton fushën e veprimit dhe të drejtat dhe detyrat e subjekteve të përmendura në paragrafin 1 më sipër. Statuti dhe rregulloret e tyre do të jenë në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e statutit dhe rregulloreve të FSHF-së. FSHF do të ketë kompetencë ekskluzive dhe të padelegueshme për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me arbitrimin, luftën kundër dopingut, regjistrimin e lojtarëve, licencimin e klubeve, vendosjen e masave disiplinore, përfshirë shkeljet etike, si dhe masat e kërkuara për të mbrojtur integritetin e garave, përfshirë luftën kundër trukimeve të ndeshjeve.
3. Subjektet e përmendura në paragrafin 1 më sipër do të marrin të gjitha vendimet për çdo çështje në lidhje me anëtarësimin e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo person i jashtëm. Ky detyrim zbatohet pavarësisht nga struktura e tyre e organizimit.
4. Në çdo rast, asnjë person fizik ose juridik (përfshirë shoqëritë *holding* dhe filialet) nuk do të ushtrojë kontroll mbi më shumë se një klub ose grup klubesh sa herë që mund të cenohet integriteti i ndonjë ndeshjeje ose gare.

### III. PRESIDENTI I NDERIT DHE ANËTARI I NDERIT

---

#### **NENI 24      PRESIDENTI I NDERIT DHE ANËTARI I NDERIT**

---

1. Asambleja e Përgjithshme i jep titullin “President Nderi” ose “Anëtar Nderi” çdo personi për shërbime dhe kontribute të shquara ndaj futbollit. Në mënyrë që të miratohet kërkesa, kërkohet shumica e dy të tretave të votave të vlefshme.
2. Këto propozime bëhen nga Komiteti Ekzekutiv. President nderi propozohet vetëm një individ i cili ka kryer më parë detyrën e Presidentit të FSHF-së. Anëtar nderi mund të propozohet vetëm një individ i cili ka qenë më parë anëtar i organeve të FSHF.
3. Presidenti i Nderit merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv duke u përfshirë në diskutime, por pa të drejtë vote. Anëtar i Nderit mund të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme duke u përfshirë në diskutime, por pa të drejtë vote.

## IV. ORGANIZIMI

### NENI 25 ORGANET E FSHF-SË

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë dhe legjislativ.
2. Komiteti Ekzekutiv është organi strategjik dhe mbikëqyrës i cili drejtohet nga Presidenti.
3. Sekretariati i Përgjithshëm është organi ekzekutiv, operacional dhe administrativ.
4. Komisionet e përhershme dhe të përkohshme këshillojnë dhe ndihmojnë Komitetin Ekzekutiv dhe Sekretariatit të Përgjithshëm për përmbushjen e detyrave të tyre.
5. Organet e licencimit të klubeve janë përgjegjëse për sistemin e licencimit të klubeve brenda FSHF-së.
6. Komisionet e pavarura përmbushin funksionet e tyre në përputhje me këtë statut dhe rregulloret në fuqi. Komisionet e pavarura janë Komisioni i Auditit, Komisioni i Verifikimit dhe organet gjyqësore.
7. Organet e Administrimit të Drejtësisë Sportive: Komisioni i Disiplinës dhe Etikës, Komisioni i Apelit, inspektorët e disiplinës dhe Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve.
8. Organet zgjidhen ose emërohen nga vetë FSHF pa ndikim të jashtëm të papërshtatshëm dhe në përputhje me procedurat e përshkruara në këtë statut.
9. Çdo anëtar i organeve duhet të tërhiqet nga diskutimet dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku, perceptimi ose mundësia e konfliktit të interesit. Në veçanti, anëtarët e organeve duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshëm dhe të veprojnë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Etikës të FIFA-s

mbi konfliktin e interesit dhe të rregullojnë sjelljen e tyre kur është e nevojshme (p.sh. të abstenojnë nga kryerja e detyrave të tyre, të njoftojnë kryetarin në rastet e konflikteve të mundshme të interesit, etj.).

---

## **NENI 26 SHKARKIMI I NJË ANËTARI TË NJË ORGANI**

---

1. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë një anëtar të një organi. Komiteti Ekzekutiv gjithashtu mund të shkarkojë një anëtar të një organi përkohësisht. Shkarkimi i përkohshëm i miratuar nga Komiteti Ekzekutiv duhet të konfirmohet nga Asambleja e Përgjithshme e ardhshme, përveç se nëse Komiteti Ekzekutiv e ka revokuar ndërkohë shkarkimin. Nëse Asambleja e Përgjithshme e ardhshme është e natyrës zgjedhore, anëtari i shkarkuar do të lejohet të jetë kandidat (me kusht që ai të përmbushë kriteret përkatëse të pranueshmërisë) në një bazë të kushtëzuar në varësi të vendimit përfundimtar të Asamblesë së Përgjithshme për shkarkimin e tij, vendim i cili do të merret para zgjedhjeve.
2. Kërkesa për shkarkim duhet të jetë e motivuar dhe do t'u dërgohet anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe/ose anëtarëve të FSHF-së së bashku me rendin e ditës përkatës.
3. Anëtari i organit në fjalë ka të drejtë të mbrohet përpara Komitetit Ekzekutiv dhe/ose Asamblesë së Përgjithshme.
4. Kërkesa për shkarkimin do të vendoset me votim të fshehtë të Komitetit Ekzekutiv dhe/ose Asamblesë Përgjithshme. Që kërkesa të miratohet, kërkohet prania e shumicës (më shumë se 50%) së anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe/ose anëtarëve dhe shumica e dy të tretave të votave të vlefshme të të pranishmëve.
5. Anëtari i shkarkuar (përkohësisht ose jo) lirohet nga funksionet e tij me efekt të menjëhershëm.

**A. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME****NENI 27 PËRKUFIZIME DHE PËRBËRJA**

1. Asambleja e Përgjithshme është mbledhja ku anëtarët e drejtpërdrejtë në FSHF mblidhen rregullisht dhe përfaqësohen nga delegatë. Asambleja e Përgjithshme përfaqëson autoritetin më të lartë dhe legjislativ të FSHF-së. Vetëm kur mblidhet sipas rregullave të parashikuara, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme konstituohet në përputhje me parimet e demokracisë përfaqësuese dhe merr parasysh rëndësinë e barazisë gjinore, interesat e futbollit të femrave dhe përfaqësimin e shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
4. Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Presidenti, në përputhje me këtë statut, rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme, si dhe çdo rregulloreje të zbatueshme.
5. Komiteti Ekzekutiv mund të caktojë vëzhgues për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, pa të drejtë për të debatuar ose për të votuar.
6. Presidenti i Nderit dhe/ose Anëtarët e Nderit marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme duke u përfshirë në diskutime, por pa të drejtë vote.

**NENI 28 DELEGATËT DHE VOTAT**

1. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga anëtarë me anëtarësi të drejtpërdrejtë, të ndarë si më poshtë:

- a) Futbolli profesionist: klube që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore dhe Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Parë.
  - b) Futbolli amator i përbërë nga shoqatat rajonale siç listohen në nenin 13, paragrafi 2 (b).
  - c) Shoqatat e Profesioneve të lidhura me futbollin siç listohen në nenin 13, paragrafi 2 (c).
2. Komisioni i Verifikimit do të përcaktojë numrin e delegatëve të caktuar për futbollin profesionist, futbollin amator dhe shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin. Përcaktimi do të kryhet në rendin vijues duke përdorur metodën më poshtë:
- a) Çdo klub që merr pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore dhe Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Parë në momentin mbajtjes së asamblesë ka të drejtë të ketë një (1) delegat. Nëse i njëjti klub merr pjesë në një ose më shumë gara të futbollit profesionist, futbollit amator ose futbollit të femrave, klubi do të ketë vetëm një (1) delegat gjithsej.
  - b) Numri i delegatëve që përfaqësojnë futbollin amator përmes shoqatave rajonale do të jetë i barabartë me numrin e delegatëve të futbollit profesionist dhe do të ndahet si vijon: Secila shoqatë rajonale ka të drejtë të ketë një (1) delegat. Delegatët e tjerë do të shpërndahen më pas midis të njëjtave shoqata rajonale në bazë të numrit të përgjithshëm të lojtarëve të regjistruar pjesëmarrës në kampionatet rajonale të të gjitha niveleve. Numri total i lojtarëve përfshin lojtarët e regjistruar me klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Dytë, klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Tretë; dhe klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Femrave e që nuk janë të përfaqësuara drejtpërdrejtë në një klub sipas pikës 2 të këtij neni. Numri i delegatëve do të rumbullakoset deri në numrin e plotë më të afërt derisa të gjithë delegatët

t'i atribuohen një shoqate rajonale.

- c) Shoqatat e Profesioneve të lidhura me futbollin siç listohen në nenin 13, paragrafi 2 (c) kanë të drejtë të kenë një (1) delegat secila.

Në rast se numri i klubeve pjesëmarrëse në futbollin profesionist rritet ose zvogëlohet, numri i delegatëve për futbollistët amatorë do të rritet ose zvogëlohet në përputhje me rrethanat. Komisioni i Verifikimit do të vijojë me rregullimet e nevojshme sapo vendimi për rritjen ose zvogëlimin e numrit të klubeve të jetë bërë përfundimtar.

3. Delegatët duhet t'i përkasin anëtarit që ata përfaqësojnë dhe të emërohen ose zgjidhen nga organi i caktuar nga statuti i anëtarit 20 ditë përpara brenda 20 ditëve nga data e datës së Asamblesë së Përgjithshme. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje ta vërtetojnë këtë gjë. Delegimi i personave jo-anëtarë nuk lejohet.
4. Secili delegat ka një votë në Asamblenë e Përgjithshme. Vetëm delegatët e pranishëm kanë të drejtë vote. Votimi me prokurë ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.
5. Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe të Sekretariatit të Përgjithshëm marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë vote. Gjatë mandatit të tyre, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv nuk mund të emërohen si delegatë në Asamblenë e Përgjithshme.

---

## **NENI 29 FUSHAT E KOMPETENCAVE**

---

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Të miratojë ose ndryshojë këtë Statut dhe Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme;
- b) Të caktojë tre anëtarë për të kontrolluar procesverbalet dhe për të shqyrtuar procesverbalet e mbledhjes së fundit;
- c) Të zgjedhë Presidentin dhe anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv;

- d) Zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura (d.m.th. Komisioni i Auditit, Komisioni i Verifikimit dhe organet gjyqësore), me propozimin e Komitetit Ekzekutiv;
- e) Të emërojë vëzhguesit për të numëruar votat dhe për të ndihmuar Sekretarin e Përgjithshëm për shpërndarjen e fletëve të votimit për zgjedhjet;
- f) Të miratojë pasqyrat vjetore financiare të audituara, përfshirë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin financiar vjetor;
- g) Të miratojë buxhetin;
- h) Të miratojë raportin e aktivitetit, i cili përmban aktivitetet e FSHF-së që nga Asambleja e Përgjithshme e kaluar;
- i) Të emërojë audituesin e pavarur të jashtëm me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- j) Të përcaktojë pranimet e anëtarësisë me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
- k) Të japë titullin “President Nderi” ose “Anëtar Nderi”, me propozimin e Komitetit Ekzekutiv;
- l) Të pranojë, të pezullojë ose përjashtojë një anëtar;
- m) Të shkarkojë një anëtar të një organi të FSHF-së;
- n) Të shpërbëjë FSHF-në dhe të vendosë për përdorimin e aktiveve të saj financiare kur kjo kërkohet nga 2/3 e anëtarëve me të drejtë të vlefshme vote.
- o) Të miratojë vendimet me kërkesë të një anëtari në përputhje me këtë statut ose të miratojë ndonjë vendim që i është besuar Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me këtë statut.



---

**NENI 30 KUORUMI**

---

1. Vendimet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme do të jenë të vlefshme vetëm nëse në mbledhje, është e pranishme shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve me të drejtë vote.
2. Nëse kuorumi nuk arrihet, zhvillohet një Asamble e Përgjithshme e dytë me të njëjtën rend dite brenda 24 orëve.
3. Kuorumi nuk kërkohet për mbledhjen e dytë të Asamblesë së Përgjithshme përveç se nëse në rendin e ditës është e parashikuar një nga çështjet e mëposhtme:
  - a) një ndryshim të këtij statuti apo rregullores së Asamblesë së Përgjithshme;
  - b) zgjedhja e Presidentit ose e anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv;
  - c) zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarëve ose anëtarëve të komisioneve të pavarura;
  - d) shkarkimin e një anëtari të një organi të FSHF-së;
  - e) pezullimin ose përjashtimin e një anëtari;
  - f) shpërbërjen e FSHF-së.

Për vendimmarrjen për pikat e sipërpërmendura, është e nevojshme shumica e përcaktuar në paragrafin 1 më sipër.
4. Nga momenti që deklarohet se Asambleja e Përgjithshme është thirrur dhe mbledhur në përputhje me këtë statut, kuorumi nuk do të ndikohet nga delegatët që largohen nga mbledhja.

---

**NENI 31 VENDIMET**

---

1. Vendimet që hidhen në votë, do të merren me anë të ngritjes së duarve ose me anë të numërimit elektronik, përveçse nëse një e treta e anëtarëve kërkon që të bëhet votim i fshehtë. Nëse

ngritja e duarve nuk çon në një shumicë të qartë në favor të një vendimi, votimi do të bëhet duke thirrur listën e delegatëve në rend alfabetik.

2. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë statut, shumica (më shumë se 50%) e votave të vlefshme të dhëna në favor, është e mjaftueshme që një vendim të merret. Fletët bosh të votimit, votat e pavlefshme ose votat elektronike të manipuluar në çdo mënyrë, si dhe abstenimet nuk merren në konsideratë kur llogaritet shumica.

---

## **NENI 32 ZGJEDHJET**

---

1. Zgjedhjet zhvillohen me votim të fshehtë. Megjithatë, nëse numri i kandidatëve është i barabartë me numrin e pozicioneve të lira, për të cilat mbahen zgjedhjet, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të procedojë ndryshe.
2. Zgjedhjet do të kryhen në përputhje me Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së dhe do të mbikëqyren nga Komisioni i Verifikimit.
3. Zgjedhjet për pozicionet brenda Komitetit Ekzekutiv do të bëhen sipas pozicionit (së pari Presidenti, dhe më pas anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv). Të paktën një pozicion do të rezervohet për një kandidate grua.
4. Kandidatët për president duhet të propozohen nga të paktën 5 (pesë) anëtarë. Çdo kandidat për anëtar të Komitetit Ekzekutiv duhet të propozohet nga të paktën 2 anëtarë, për t'u marrë në konsideratë nga Asambleja e Përgjithshme. Secili anëtar mund të propozojë vetëm një kandidat në zgjedhje për pozicionet brenda Komitetit Ekzekutiv (presidentin dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv). Nëse një anëtar mbështet më shumë se një kandidat, asnjë nga shprehjet e mbështetjes së tij nuk do të konsiderohet e vlefshme.

5. Për zgjedhjen e Presidentit, shumica e dy të tretave të votave të vlefshme janë të nevojshme në raundin e parë. Në rast se asnjë kandidat nuk e arrin këtë shumicë, zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve midis dy kandidatëve që kanë marrë shumicën e votave të vlefshme të dhëna në raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr shumicën e votave të vlefshme të dhëna, zgjidhet President. Në rast barazimi, do të zhvillohet raundi i tretë, ku do të zbatohet e njëjta shumicë. Në rast se edhe raundi i tretë përfundon me barazim, Presidenti caktohet me short, i cili hidhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe monitorohet nga Komisioni i Verifikimit.
6. Për zgjedhjen e anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv, kandidatët renditen në rend alfabetik. Secili anëtar mund të votojë për aq kandidatë sa janë pozicionet e lira ose më pak. Nëse nuk ka asnjë grua kandidate për Komitetin Ekzekutiv, vendi mbetet vakant deri në Asamblenë e Përgjithshme të radhës ku një kandidate grua do të zgjidhet për pjesën e mbetur të mandatit. Një kandidat zgjidhet Anëtar i Komitetit Ekzekutiv nëse merr shumicën absolute (50% + 1 votë) në raundin e parë. Nëse nuk ka kandidatë të mjaftueshëm që mbështeten me shumicë absolute, për të mbushur vendet vakante mbahet një raund i dytë në të cilin një shumicë e thjeshtë (numri i më i madh i votave) është i mjaftueshëm për një kandidat që të zgjidhet. Në rast barazimi, rezultati përcaktohet me short i cili hidhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe monitorohet nga Komisioni i Verifikimit.
7. Për zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura (d.m.th. Komisionit të Auditit, Komisionit të Verifikimit dhe organeve gjyqësore), kandidati (ose kandidatët) që merr (ose marrin) më shumë vota, shpallen fitues. Këto zgjedhje mund të kryhen në bllok.
8. Për zgjedhjen e Presidentit, anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv, kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të pavarura, kandidati ose kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri;
  - b) Të mos jetë dënuar për një krim të rëndë, përfshirë veprën penale të parashikuar nga Neni 197/a i Kodit Penal ose të jetë rehabilituar sipas legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë si dhe të mos jetë i dënuar për trukim ndeshjesh nga organet e FIFA, UEFA ose FSHF;
  - c) Të japë një deklaratë me shkrim ku personi deklaron se jep dorëheqjen nga funksionet e tij brenda FSHF-së dhe/ose anëtarëve të saj nëse zgjidhet;
  - d) Të jetë nën moshën 70 vjeç në datën e mbajtjes së Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore;
  - e) Të jete i përshtatshëm për pozicionin;
  - f) Nuk duhet të jenë apo të kenë qenë, deputetë, kandidatë për deputetë, anëtarë të organeve drejtuese në ndonjë parti politike, ose funksionar politik në 5 vitet e fundit.
9. Fletët bosh të votimit, votat e pavlefshme ose votat elektronike të manipuluar në çdo mënyrë, si dhe abstencimet nuk merren në konsideratë kur llogaritet shumica.
10. Kandidaturat për cilindo nga pozicionet e Komitetit Ekzekutiv do të dërgohen në Sekretariatit e Përgjithshëm të paktën 20 ditë para Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore përkatëse. Lista zyrtare e kandidatëve duhet t'u kalohet anëtarëve të FSHF-së të paktën 10 ditë para Asamblesë së Përgjithshme ku do të zgjidhet Komiteti Ekzekutiv. Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen gjithashtu kur zgjedhjet zhvillohen gjatë një Asambleje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme.
11. Kandidaturat për cilindo nga pozicionet e komisioneve të pavarura (d.m.th. Komisionin e Auditit, Komisionin e Verifikimit dhe organet gjyqësore) duhet t'i dërgohen Sekretariatit të Përgjithshëm të paktën 20 ditë para Asamblesë së Përgjithshme ku do të zgjidhen anëtarët në fjalë. Lista përfundimtare e kandidatëve duhet t'i dërgohet anëtarëve të FSHF të paktën 10 ditë përpara Asamblesë së Përgjithshme.

---

**NENI 33 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME**


---

1. Asambleja e Përgjithshme e zakonshme mbahet çdo vit jo më vonë se data 30 qershor.
2. Komiteti Ekzekutiv përcakton vendin dhe datën e Asamblesë së Përgjithshme. Anëtarët njoftohen me shkrim të paktën 30 ditë përpara për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
3. Çdo propozim që një anëtar dëshiron t'i paraqesë Asamblesë së Përgjithshme, i dërgohet me shkrim Sekretariatit të Përgjithshëm, me një shpjegim të shkurtër, të paktën 20 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme.
4. Sekretariati i Përgjithshëm, të paktën 10 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme u dërgon anëtarëve me shkrim rendin përfundimtar të ditës, raportin e aktivitetit, pasqyrat financiare, raportin e audituesve të pavarur dhe çdo dokument tjetër të lidhur me rendin e ditës dhe me kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.

---

**NENI 34 RENDI I DITËS I ASAMBLËSË SË PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME**


---

1. Sekretari i Përgjithshëm harton rendin e ditës në bazë të propozimeve të Komitetit Ekzekutiv dhe anëtarëve.
2. Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme përmban çështjet e mëposhtme të detyrueshme (në rend kronologjik):
  - a) Deklarimin e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe përbërjen e saj në përputhje me këtë statut;
  - b) Miratimin e rendit të ditës;
  - c) Fjalimin e Presidentit;
  - d) Emërimin e anëtarëve për të kontrolluar procesverbalet;

- e) Emërimin e Vëzhguesve;
  - f) Pezullimin ose përjashtimin e anëtarëve (nëse aplikohet);
  - g) Miratimin e procesverbalit të Asamblesë së Përgjithshme paraardhëse;
  - h) Raportin e aktivitetit (që përmban aktivitetet që nga Asambleja e Përgjithshme e mëparshme);
  - i) Prezantimin e bilancit të konsoliduar dhe pasqyrave të fitimit dhe humbjes, si dhe raportin e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm;
  - j) Miratimin e pasqyrave financiare të audituara;
  - k) Miratimin e buxhetit;
  - l) Votimin për propozimet për ndryshime në këtë statut dhe/ose rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme (nëse është e zbatueshme);
  - m) Diskutimin e propozimeve të paraqitura nga Komiteti Ekzekutiv ose anëtarët në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 32, paragrafi 3 të këtij Statuti;
  - n) Emërimin e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm (nëse është e zbatueshme) me propozim të Komitetit Ekzekutiv;
  - o) Shkarkimin e një anëtari të një organi të FSHF-së (nëse është e zbatueshme);
  - p) Zgjedhjen e Presidentit dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv (nëse zbatohet);
  - q) Zgjedhjen e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura, d.m.th. të Komisionit të Auditit, Komisionit të Verifikimit dhe organeve gjyqësore (nëse ka);
  - r) Pranimin për anëtarësim (nëse është e zbatueshme).
3. Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për pikat të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
4. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme mund të ndryshohet me kusht që dy të tretat e anëtarëve të pranishëm

me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të bien dakord me një kërkesë të tillë.

---

**NENI 35 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E JASHTËZAKONSHME**

1. Komiteti Ekzekutiv mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme në çdo kohë.
2. Komiteti Ekzekutiv e mbledh Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme nëse dy e treta e anëtarëve të FSHF-së bëjnë një kërkesë të tillë me shkrim. Kërkesa përcakton pikat që do të përfshihen në rendin e ditës. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme do të mbahet brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim. Nëse nuk thirret Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme, anëtarët që e kërkuan atë mund të mbledhin vetë Asamblenë e Përgjithshme e Jashtëzakonshme. Duke vepruar kështu, ata informojnë të gjithë anëtarët e FSHF-së dhe Komitetin Ekzekutiv për datën dhe vendndodhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, së bashku me pikat që do të përfshihen në rendin e ditës në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.
3. Anëtarët do të njoftohen për vendin dhe datën të paktën 10 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme.
4. Kur Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme thirret me iniciativën e Komitetit Ekzekutiv, ai duhet të hartojë rendin e ditës. Kur thirret me kërkesë të anëtarëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga vetë anëtarët. Anëtarët që kanë thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme, të paktën 10 ditë para datës së Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme duhet t'u dërgojnë anëtarëve dhe Komitetit Ekzekutiv rendin e ditës dhe çdo dokument tjetër që lidhet me rendin e ditës.
5. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet.

---

**NENI 36                    NDRYSHIMET NË STATUT DHE RREGULLOREN  
E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

---

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për ndryshimin e këtij statuti dhe Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme.
2. Çdo propozim për ndryshim të këtij statuti dhe Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme duhet të paraqitet me shkrim me një shpjegim të shkurtër në Sekretariatit e Përgjithshëm nga një anëtar ose nga Komiteti Ekzekutiv. Është i vlefshëm edhe propozimi i paraqitur nga delegatët që përfaqësojnë një anëtar, me kusht që të jetë mbështetur me shkrim nga të paktën dy delegatë të tjerë që përfaqësojnë anëtarët.
3. Në mënyrë që votimi mbi një ndryshim të statutit dhe/ose të Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme të jetë i vlefshëm, duhet të jetë e pranishme shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve me të drejtë vote.
4. Propozimi për një ndryshim të këtij statuti dhe të Rregullores së Asamblesë së Përgjithshme do të miratohet vetëm nëse dy të tretat e anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote, votojnë në favor të ndryshimeve të propozuara.

---

**NENI 37                    PROCESVERBALET**

---

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Anëtarët e caktuar për të verifikuar procesverbalet duhet ta bëjnë këtë në mënyrë që procesverbalet t'u dërgohen anëtarëve brenda 30 ditëve nga Asambleja e Përgjithshme. Procesverbali do të konsiderohet i aprovuar nëse, brenda 10 ditëve nga dërgimi i tij, nuk paraqiten kundërshtime me shkrim në Sekretariatit e Përgjithshëm. Në rast të marrjes së ndonjë kundërshtimi,



procesverbali vendoset për shqyrtim në rendin e ditës të Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme pasardhëse.

---

**NENI 38            DATA E HYRJES NË FUQI TË VENDIMEVE**

---

Vendimet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme do të hyjnë në fuqi menjëherë pas përfundimit të Asamblesë së Përgjithshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë statut, ose nëse Asambleja e Përgjithshme përcakton një datë tjetër për hyrjen në fuqi të një vendimi.

## B. KOMITETI EKZEKUTIV

---

### NENI 39 PËRBËRJA

---

1. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, ku të paktën njëri prej të cilëve është grua, me përbërjen e mëposhtme:
  - a) 1 President;
  - b) 2 zëvendëspresidentë;
  - c) 8 anëtarë.
2. Komiteti Ekzekutiv zgjedh midis anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv zëvendëspresidentin e parë dhe të dytë; Presidenti mund të shprehë propozimet e tij. Këto zgjedhje zhvillohen gjatë mbledhjes së parë pas zgjedhjes së Presidentit dhe anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me nenin 32 të këtij statuti. Të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv i nënshtrohen kontrollit të integritetit, i cili kryhet nga Komisioni i Verifikimit, para zgjedhjes ose rizgjedhjes së tyre.
3. Presidenti dhe anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv kanë mandat 4-vjeçar. Mandatet do të ndjekin të njëjtin cikël zgjedhor. Mandatet e tyre fillojnë menjëherë pas përfundimit të Asamblesë së Përgjithshme që i ka zgjedhur ata dhe përfundojnë në fund të Asamblesë së Përgjithshme që zgjedh pasardhësit e tyre.
4. Të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv duhet të plotësojnë kushtet paraprake të parashikuara në nenin 31, paragrafi 7 i këtij statuti.
5. Një anëtar i Komitetit Ekzekutiv nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i një komisioni të pavarur dhe nuk mund të emërohet/zgjidhet si delegat që përfaqëson një anëtar në Asamblenë e Përgjithshme.

6. Nëse një pozicion ose deri në 50% të pozicioneve të Komitetit Ekzekutiv janë vakante, Komiteti Ekzekutiv e plotëson pozicionin (et) në fjalë deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme, kur do të zgjidhen zëvendësuesit e pozicioneve përkatëse për periudhën e mbetur të ushtrimit të detyrës. Zëvendësuesit e emëruar nga Komiteti Ekzekutiv konsiderohen automatikisht si kandidatë, me kusht që të përmbushen kushtet paraprake të parashikuara në nenin 31, paragrafi 7, i këtij statuti.
7. Nëse më shumë se 50% të pozicioneve të Komitetit Ekzekutiv janë vakante, anëtarët e mbetur do të thërrasin një Asamble e Përgjithshme e Jashtëzakonshme brenda periudhës së parashikuar kohore të parashikuar në Nenin 35, paragrafi 2 i Statutit. Në rast se, brenda 1 (një) jave nga kalimi i afatit, anëtarët e mbetur nuk e thërrasin Asamblenë e përgjithshme, atë e thërret Sekretari i Përgjithshëm.
8. Çdo pozicion brenda Komitetit Ekzekutiv konsiderohet vakant në rast vdekjeje, dorëheqjeje ose nëse anëtari në fjalë pëson një pengesë të përhershme për kryerjen e funksionit e tij.

---

## **NENI 40 MBLEDHJET**

---

1. Komiteti Ekzekutiv mblidhet të paktën 6 (gjashtë) herë në vit.
2. Presidenti thërret mbledhjet e Komitetit. Nëse të paktën 4 (katër) anëtarë të Komitetit Ekzekutiv kërkojnë mbledhjen e Komitetit, Presidenti e thërret atë në mënyrë që takimi të mbahet brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës. Nëse Presidenti nuk e thërret mbledhjen e kërkuar brenda afatit të sipërpërmendur, mbledhja do të thirret nga vetë anëtarët e tjerë të Komitetit Ekzekutiv, por ata duhet t'ua dërgojnë rendin e ditës të gjithë anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të paktën 5 (pesë) ditë para mbledhjes, në përputhje me paragrafin 3 më poshtë.

3. Presidenti, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, harton rendin e ditës duke njoftuar anëtarët dhe Presidentin e Nderit të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara mbledhjes. Secili anëtar i Komitetit Ekzekutiv ka të drejtë të propozojë çështje për t’u përfshirë në rendin e ditës pranë Sekretarisë së Përgjithshme të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes. Rendi përfundimtar i ditës dhe materialet përkatëse duhet t’u dërgohet anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të paktën tre ditë përpara mbledhjes.
4. Sekretari i Përgjithshëm dhe Presidenti i Nderit do të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv në rol konsultativ dhe pa të drejtë vote. Nëse Sekretari i Përgjithshëm nuk është në gjendje të marrë pjesë në një mbledhje, ai mund të emërojë një përfaqësues për të marrë pjesë në mbledhje në emër të tij, me kusht që të miratohet nga Komiteti Ekzekutiv.
5. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv mbahen me dyer të mbyllura. Sidoqoftë, Komiteti Ekzekutiv mund të ftojë palët e treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk do të kenë të drejtë vote dhe mund të shprehin opinione vetëm me lejen e Komitetit Ekzekutiv.
6. Presidenti gjithashtu mund të thërrasë Komitetin Ekzekutiv në mënyrë urgjente për të trajtuar çdo çështje që kërkon zgjidhje të menjëhershme midis dy takimeve të Komitetit Ekzekutiv. Nëse anëtarët e Komitetit Ekzekutiv nuk mund të takohen fizikisht dhe i nënshtrohen dispozitave të nenit 41, paragrafi 1 dhe 2, vendimet mund të merren përmes mjeteve të tjera moderne të komunikimit.

---

## **NENI 41      KOMPETENCAT**

---

Komiteti Ekzekutiv ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Të miratojë vendimet për të gjitha çështjet të cilat nuk hyjnë në kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ose nuk janë të rezervuara për organe të tjera të FSHF me ligj, në bazë të

- këtij statuti apo rregulloreve të brendshme;
- b) Të zgjedhë midis anëtarëve të vet zëvendës-presidentin e parë dhe të dytë;
  - c) Të sigurojë zbatimin e këtij statuti dhe miratimin e vendimeve ekzekutive të kërkuara për zbatimin e tyre, përfshirë miratimin dhe nxjerrjen e Rregullores së Organizimit të Brendshëm të FSHF-së, rregulloret për organizimin e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme ose rregulloreve të tjera përkatëse;
  - d) Të administrojë dhe të drejtojë aktivitetet e FSHF-së në përputhje me këtë statut;
  - e) Të përgatisë dhe rishikojë buxhetin, duke përfshirë përdorimin e fondeve për shpenzime të papritura në buxhet që nuk tejkalojnë masën 10% të buxhetit vjetor të FSHF-së, të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme më të fundit;
  - f) Të përgatisë, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, dhe të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme e të Jashtëzakonshme;
  - g) Të emërojë kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme;
  - h) Të vendosë për krijimin e komisioneve të posaçme nëse është e nevojshme në çdo kohë;
  - i) Të emërojë dhe të shkarkojë Sekretarin e Përgjithshëm, me propozim të Presidentit;
  - j) Të propozojë audituesit e pavarur dhe të jashtëm në Asamblenë e Përgjithshme;
  - k) Të caktojë zëvendësues për vendet vakante të punës në komisionet e pavarura deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme;
  - l) Të miratojë dhe të nxjerrë rregullore që rregullojnë kushtet e pjesëmarrjes dhe organizimin e garave të organizuara nga FSHF;

- m) Të emëroje ose shkarkojë trajnerët e ekipeve përfaqësuese dhe personelin teknik të tyre sipas propozimeve të Presidentit.
- n) Të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FSHF-së për zgjedhje/emërime në organe të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
- o) Të shkarkojë një anëtar të një organi, ose të pezullojë një anëtar të FSHF-së provizorisht deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme;
- p) Të propozojë kandidatura të përshtatshme për titullin “President Nderi” dhe “Anëtar Nderi” të FSHF-së;
- q) Të delegojë kompetencat e tij organeve të tjera;
- r) Të caktojë vëzhgues të cilët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme pa të drejtë për të debatuar ose për të votuar.

---

## **NENI 42      VENDIMET**

---

1. Komiteti Ekzekutiv konsiderohet i mbledhur rregullisht vetëm nëse janë të pranishëm të paktën 6 (gjashtë) nga anëtarët e tij.
2. Komiteti Ekzekutiv merr vendime me shumicën absolute (50% + 1 votë) të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të pranishëm dhe të votave të vlefshme. Votimi me prokurë ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.
3. Çdo anëtar i Komitetit Ekzekutiv duhet të tërhiqet nga debati dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku ose mundësia e konfliktit të interesit.
4. Vendimet e marra regjistrohen në procesverbal.
5. Vendimet e marra nga Komiteti Ekzekutiv hyjnë në fuqi menjëherë, përveç nëse Komiteti Ekzekutiv vendos ndryshe.

**C. PRESIDENTI****NENI 43      PRESIDENTI**

1. Presidenti është kryesisht përgjegjës për:
  - a) thirrjen e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Komitetit Ekzekutiv;
  - b) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe Komiteti Ekzekutiv përmes Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - c) sigurimin e funksionimit efektiv të organeve në mënyrë që ato të arrijnë objektivat e përshkruar në këtë statut;
  - d) mbikëqyrjen e punës së Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - e) marrëdhëniet midis FSHF-së dhe anëtarëve të saj, FIFA-s, UEFA-s, organeve politike dhe organizatave të tjera.
2. Vetëm Presidenti mund t'i propozojë Komitetit Ekzekutiv emërimin ose shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe emërimin ose shkarkimin e trajnerëve të ekipeve përfaqësuese dhe personelin teknik të tyre.
3. Presidenti kryeson Asamblenë e Përgjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe ato komisione në të cilat ai është emëruar kryetar.
4. Presidenti do të ketë 1 (një) votë të zakonshme në Komitetin Ekzekutiv. Në rast barazie të votave, Presidenti ka votë vendimtare.
5. Nëse Presidenti mungon ose nuk është i disponueshëm, ai zëvendësohet nga zëvendës-presidenti i parë. Nëse edhe ky i fundit mungon, ai zëvendësohet nga zëvendës-presidenti i dytë.
6. Nëse pozicioni i Presidentit bëhet vakant në kuptimin e nenit 39, paragrafi 8, të këtij statuti, ai zëvendësohet nga zëvendës-presidenti deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme. Kjo Asamble

e Përgjithshme do të zgjedhë Presidentin e ri për periudhën e mbetur të mandatit.

7. Çdo kompetencë shtesë e Presidentit përcaktohet në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të FSHF-së.

---

#### **NENI 44 PËRFAQËSIMI DHE NËNSHKRIMI**

---

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm, ose një nga zëvendëspresidentët dhe Sekretari i Përgjithshëm, mund të nënshkruajnë bashkërisht në emër të FSHF-së, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe në rregulloret e organizimit të brendshëm të FSHF-së.



**D. SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM****NENI 45 SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM**

Sekretariati i Përgjithshëm është organ ekzekutiv, operacional dhe administrativ dhe e kryen detyrat nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Anëtarët e Sekretariatit të Përgjithshëm duhet të respektojnë rregulloret e organizimit të brendshëm të FSHF-së dhe do të përmbushin detyrat e caktuara në mirëbesim.

**NENI 46 SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

1. Sekretari i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i FSHF-së. Në mungesë të tij, ai emëron një zëvendësues nga Sekretariati i Përgjithshëm.
2. Sekretari i Përgjithshëm emërohet nga Komiteti Ekzekutiv, me propozim të Presidentit, në bazë të një marrëveshjeje të rregulluar nga e drejta private dhe duhet të ketë kualifikimet dhe/ose përvojën e nevojshme profesioniste. Komiteti Ekzekutiv është gjithashtu organi përgjegjës për shkarkimin e Sekretarit të Përgjithshëm.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për:
  - a) zbatimin e vendimeve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe Komiteti Ekzekutiv në përputhje me direktivat e Presidentit dhe organeve të tjera;
  - b) pjesëmarrjen në Asamblenë e Përgjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
  - c) organizimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve të Komitetit Ekzekutiv dhe organeve të tjera;

- d) përpilimin e procesverbalit për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, Komitetit Ekzekutiv dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;
  - e) administrimin dhe mbajtjen e llogarive;
  - f) korrespondencën;
  - g) marrëdhëniet me anëtarët, komisionet e FIFA-s dhe UEFA-s, nën drejtimin e Presidentit;
  - h) organizimin e Sekretariatit të Përgjithshëm;
  - i) emërimin dhe shkarkimin e personelit që punon në Sekretariatin e Përgjithshëm;
  - j) sigurimin e mbështetjes logjistike dhe operative për zgjedhjet për Komisionin e Verifikimit.
  - k) përcaktimi i strukturës organizative të FSHF.
4. Çdo përgjegjësi dhe detyrë shtesë e caktuar për Sekretarin e Përgjithshëm përcaktohet në Rregulloren e Organizimit të Brendshëm të FSHF-së.
5. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të jetë delegat në Asamblenë e Përgjithshme ose anëtar i ndonjë organi tjetër.

**E. KOMISIONET E PËRHERSHME****NENI 47 KOMISIONET E PËRHERSHME**

1. Komisionet e përhershme janë:
  - a) Komisioni i Ligave dhe i Garave;
  - b) Komisioni i Ekipeve Kombëtare;
  - c) Komisioni i Futsalit, Minifutbollit dhe Futbollit në Rërë;
  - d) Komisioni Teknik dhe i Zhvillimit;
  - e) Komisioni i Futbollit të Femrave;
  - f) Komisioni i Statusit të Lojtarëve;
  - g) Komisioni i Financave;
  - h) Komisioni i Arbitrimit;
  - i) Komisioni Ligjor dhe i Licencimit;
  - j) Komisioni i Futbollit të Fëmijëve dhe të Rinjve
  - k) Komisioni i Infrastrukturës dhe Projekteve
  - l) Komisioni i Mjekësisë Sportive.
2. Kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme mund të jenë anëtarë të Komitetit Ekzekutiv, me përjashtim të Komisionit të Arbitrimit, të cilët nuk mund të jenë pjesë e Komitetit Ekzekutiv. Anëtarët e secilit komision të përhershëm emërohen nga Komiteti Ekzekutiv me propozim të anëtarëve të FSHF-së, ose të Presidentit. Komiteti Ekzekutiv siguron përfaqësimin e duhur të femrave në komisionet e përhershme. Kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të përhershme caktohen për një mandat 4-vjeçar.
3. Çdo kryetar përfaqëson komisionin e tij të përhershëm dhe e kryen detyrën në përputhje me dispozitat përkatëse të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të FSHF-së, të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv.

4. Çdo kryetar cakton datat e mbledhjeve në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, siguron kryerjen e të gjitha detyrave dhe i raporton Komitetit Ekzekutiv.
5. Komiteti Ekzekutiv dhe secili komision i përhershëm (me miratimin e Komitetit Ekzekutiv) mund të krijojë, nëse është e nevojshme, një byro dhe/ose nënkomision për të zgjidhur çështjet urgjente. Çdo diskutim dhe vendim i byrosë dhe/ose nënkomisionit i raportohet komisionit të përhershëm përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur.
6. Çdo komision i përhershëm mund t'i propozojë Komitetit Ekzekutiv ndryshime në dispozitat përkatëse të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të FSHF-së që kanë të bëjnë me komisionin përkatës.
7. Komisioni i përhershëm nuk ka fuqi vendimmarrëse, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë statut ose rregulloret e organizimit të brendshëm të FSHF-së.

---

#### **NENI 48                      KOMISIONI I LIGAVE DHE I GARAVE**

---

Komisioni i Ligave dhe i Garave mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me administrimin, organizimin dhe zhvillimin e garave të organizuara nga FSHF, në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e FSHF duke pasur të drejtë të propozojë përmirësime në rregulloret përkatëse apo strukturën e garave. Komisioni i Ligave dhe i Garave përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

#### **NENI 49                      KOMISIONI I EKIPEVE KOMBËTARE**

---

Komisioni i Ekipeve Kombëtare mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të FSHF që lidhen me administrimin dhe zhvillimin e ekipeve kombëtare për meshkuj e femra në të gjitha kategoritë

e moshave. Komisioni i Ekipeve Kombëtare përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**NEN 50** **KOMISIONI I FUTSALIT. MINIFUTBOLLIT  
DHE FUTBOLLIT NË RËRË (PLAZH)**

---

Komisioni Futsalit, Minifutbollit dhe Futbollit në Rërë (plazh) mbikëqyr programet për zhvillimin dhe rritjen e futbollit të sallës, minifutbollit, futbollit në rërë (plazh) apo kategorive të tjera të futbollit me qëllim popullarizimin e këtyre kategorive dhe rritjen e nivelit të përfaqësimit në garat kombëtare e ndërkombëtare. Komisioni i Futsalit, Minifutbollit dhe Futbollit në Rërë (plazh) përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**NENI 51** **KOMISIONI TEKNIK DHE I ZHVILLIMIT**

---

Komisioni Teknik dhe i Zhvillimit do të jetë kompetent për analizimin e aspekteve themelore të trajnimit dhe zhvillimit teknik të futbollit. Ai është përgjegjës për programet zhvillimore të FSHF-së, duke hartuar dhe propozuar strategji të përshtatshme për dhënien e suportit dhe monitorimin e zbatimit të strategjive karshi anëtarëve duke ofruar asistencë për Komitetin Ekzekutiv për çështjet e zhvillimit në përgjithësi. Komisioni përbëhet nga një kryetar, një nënkryetar dhe të paktën 3 (tre) anëtarë.

---

**NENI 52** **KOMISIONI I FUTBOLLIT TË FEMRAVE**

---

Komisioni i Futbollit të Femrave mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me administrimin, organizimin dhe zhvillimin e garave për femra te organizuara nga FSHF në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e FSHF duke pasur të drejtë të propozojë përmirësime në rregulloret

përkatëse apo strukturën e garave. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**NENI 53                    KOMISIONI I STATUSIT TË LOJTARIT**

---

1. Komisioni i Statusit të Lojtarit do të monitorojë zbatimin e çështjeve të transferimit të lojtarëve në përputhje me Rregulloret e FIFA-s ose FSHF-së për regjistrimin dhe transferimin e lojtarëve duke vendosur mbi statusin e tyre. Komiteti Ekzekutiv mund të aprovojë rregullore të posaçme për regjistrimin dhe transferimin e lojtarëve. Komisioni i Statusit të Lojtarit përbëhet nga një kryetar, një nënkryetar dhe 5 (pesë) anëtar.
2. Mosmarrëveshjet e lidhura me statusin e lojtarëve që përfshijnë FSHF-në, anëtarët, klubet, lojtarët, zyrtarët, ndërmjetësit etj. do të zgjidhen nga Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve.

---

**NENI 54                    KOMISIONI I FINANCËS**

---

Komisioni i financës monitoron menaxhimin financiar dhe këshillon Komitetin Ekzekutiv mbi çështjet kontabël dhe ato të menaxhimit të aseteve. Komisioni merr në shqyrtim dhe analizon buxhetin dhe pasqyrat financiare të përgatitura nga Sekretari i Përgjithshëm duke ia parashtruar Komitetit Ekzekutiv për aprovim. Komisioni i Financës përbëhet nga një kryetar dhe 2 (dy) anëtarë.

---

**NENI 55                    KOMISIONI I ARBITRIMIT**

---

Komisioni i Arbitrimit implementon Ligjet e Lojës së IFAB. Komisioni emëron arbitrat në ndeshjet e garave të organizuara nga FSHF duke administruar çështjet e arbitrimit në bashkëpunim me administratën si dhe duke monitoruar edukuar e trajnuar arbitrat

në Republikën e Shqipërisë. Komisioni i Arbitrimit përbëhet nga një kryetar, një nënkryetar dhe 2 (dy) anëtarë të cilët duhet të jenë ish-arbitra.

---

**ENI 56 KOMISIONI LIGJOR DHE I LICENSIMIT**

---

Komisioni Ligjor dhe i Licensimit mbikëqyr respektimin e statutit dhe rregulloreve të FSHF përmes azhornimit të normave juridike në përputhje me standardet e FIFA dhe/ose UEFA. Ai mbikëqyr cilësinë e vendimmarrjes së organeve gjyqësore të FSHF dhe raporton përpara Komitetit Ekzekutiv mbi aktivitetin e tyre. Komisioni Ligjor dhe i Licensimit përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë të cilët duhet të jenë me formim juridik.

---

**ENI 57 KOMISIONI I FUTBOLLIT TË FËMIJEVE DHE TË RINJVE**

---

Komisioni i Futbollit të Fëmijëve dhe të rinjve mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me administrimin, organizimin dhe zhvillimin e garave për fëmijë dhe të rinj, në përputhje me strategjinë e FSHF-së e duke pasur të drejtë të propozojë përmirësime në politikat zhvillimore dhe rregulloret përkatëse apo strukturën e garave. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**ENI 58 KOMISIONI I INFRASTRUKTURËS DHE PROJEKTEVE**

---

Komisioni i Infrastrukturës dhe Projekteve mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me zhvillimin e infrastrukturës sportive në Shqipëri dhe administrimin e projekteve të FSHF. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**NENI 59                    KOMISIONI I MJEKËSISË SPORTIVE**

---

Komisioni i Mjekësisë Sportive mbikëqyr veprimtarinë e strukturave të Sekretariatit të Përgjithshëm lidhur me zhvillimin e mjekësisë sportive si pjesë integrale e sportit të futbollit, duke zbatuar programet dhe projektet për kualifikimin e personelit mjekësor sportiv në ekipet kombëtare dhe në klubet anëtare të FSHF. Komisioni përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë.

---

**NENI 60                    KOMISIONET E PËRKOHSHME**

---

Komiteti Ekzekutiv mund, nëse është e nevojshme, të krijojë komisione të posaçme (të përkohshme) për detyra të veçanta dhe një periudhë të kufizuar kohore. Komiteti Ekzekutiv emëron një kryetar, një zëvendëskryetar dhe numrin e duhur të anëtarëve. Detyrat dhe funksioni i komisioneve të përkohshme përcaktohen në rregullore të veçanta të miratuara nga Komiteti Ekzekutiv. Komisioni i Përkohshëm i raporton drejtpërdrejt Komitetit Ekzekutiv.



## F. ORGANET E LICENCIMIT TË KLUBEVE

---

### NENI 61 ORGANET E LICENCIMIT TË KLUBEVE

---

1. Organet e licencimit të klubeve janë përgjegjëse për sistemin e licencimit të klubeve brenda FSHF-së në përputhje me Rregulloren e Licencimit të Klubeve të FSHF-së dhe atë të UEFA-s.
2. Organet e licencimit të klubit përbëhen nga një organ i shkallës së parë i cili është Komisioni i Licencimit të Klubeve dhe një organ apelimi i cili është Komisioni i Apelit për Licencimin e Klubeve.
3. Vendimet e miratuara nga organi i apelimit për licencimin e klubeve mund të apelojnë vetëm pranë CAS-it në përputhje me parashikimet në këtë statut.

## V. KOMISIONET E PAVARURA

### NENI 62 PAVARËSIA INSTITUCIONALE

1. Komisionet e pavarura, si dhe anëtarët e tyre, kryejnë aktivitetet dhe detyrat e tyre plotësisht të pavarur, por gjithmonë në interes të FSHF-së dhe në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj.
2. Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit të Përputhshmërisë, Komisionit të Verifikimit dhe organeve gjyqësore respektojnë kriteret e pavarësisë siç përcaktohet në paragrafin 3 më poshtë.
3. Personat e përmendur në paragrafin 2 më sipër, si dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre nuk mund të ushtrojnë ose të kenë ushtruar gjatë katër viteve para fillimit të funksionit të tyre ndonjë funksion ekzekutiv në FSHF, brenda një prej Anëtarëve, një Lige ose një Klubi Futbollli (përfshirë kompanitë/organizatat e lidhura me to), dhe as mund të kenë ose të kenë pasur 4 vite para fillimit të mandatit të tyre ndonjë marrëdhënie materiale biznesi me FSHF-në, një nga anëtarët, një ligë ose një klub futbollli (duke përfshirë kompanitë/organizatat e lidhura me to). “Anëtar i ngushtë i familjes” i lidhur me një person do të thotë bashkëshorti ose bashkëjetuesi i personit në fjalë, vëllezërit e motrat, prindërit, gjyshërit, xhaxhallarët, hallat, fëmijët (përfshirë njerkun/njerkën ose fëmijë të adoptuar), kunati, kunata, vjehri ose vjehra, dhe përfshin cilindo tjetër, qoftë me lidhje gjaku ose tjetër, me të cilin individi ka një marrëdhënie të ngjashme me një marrëdhënie familjare për të cilën personi në fjalë ofron mbështetje financiare.
4. Kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e komisioneve të pavarura (me përjashtim të Komisionit të Verifikimit) i nënshtrohen

kontrollit të integritetit, i cili kryhet nga Komisioni i Verifikimit në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe të Kodit Zgjedhor përpara zgjedhjes ose rizgjedhjes.

---

## **NENI 63      KOMISIONI I AUDITIT**

---

1. Komisioni i Auditit siguron se kontabiliteti financiar është i plotë dhe i besueshëm, dhe rishikon pasqyrat financiare, pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e audituesve të pavarur dhe të jashtëm. Komisioni i Auditit përbëhet nga kryetari, një nënkryetar dhe tre anëtarë. Anëtarët e Komisionit duhet të kenë përvojë me çështjet financiare dhe/ose me çështjet rregullatore dhe ligjore dhe nuk mund të përfshihen në asnjë vendim që prek veprimtaritë e FSHF-së.
2. Komisioni i Auditit këshillon, ndihmon dhe mbikëqyr Komitetin Ekzekutiv lidhur me monitorimin e çështjeve financiare dhe të Auditit së FSHF-së, vendos mekanizmat e Auditit dhe monitoron pajtueshmërinë me rregulloret përkatëse të FSHF-së. Ai gjithashtu mbikëqyr Sekretariatit e Përgjithshëm lidhur me çështjet financiare dhe të Auditit. Komisioni i Auditit siguron se kontabiliteti financiar është i plotë dhe i besueshëm dhe rishikon pasqyrat financiare, pasqyrën financiare të konsoliduar dhe raportet e auditorëve të pavarur dhe të jashtëm. Komisioni i Auditit monitoron më tej çështjet financiare dhe të Auditit së FSHF-së dhe u sugjeron organeve përkatëse çdo veprim që ai e konsideron të nevojshëm si rezultat i një monitorimi të tillë. Komisioni i Auditit, me ndihmën e Sekretariatit të Përgjithshëm, zbaton një program pajtueshmërie brenda FSHF-së.
3. Detajet mbi përgjegjësitë e Komisionit të Auditit, bashkëpunimin e tij të brendshëm dhe çështje të tjera procedurale përcaktohen në Rregulloren e Organizimit të Brendshëm të FSHF-së.
4. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Komisionit të Auditit zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë

4-vjeçare dhe mund të shkarkohen nga detyra nga Asambleja e Përgjithshme. Ata nuk i përkasin asnjë organi tjetër të FSHF-së.

5. Nëse kryetari, nënkryetari ose një anëtar i Komisionit të Auditit pushon përfundimisht së kryeri funksionet e tij zyrtare gjatë mandatit, Komisioni emëron një zëvendësues për të shërbyer deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme.

---

## **NENI 64 KOMISIONI I VERIFIKIMIT**

---

1. Komisioni i Verifikimit është organi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në përputhje me Rregulloren e Asamblesë së FSHF-së dhe kryerjen e kontrollit të integritetit. Komisioni i Apelit shqyrton ankesat kundër vendimit të Komisionit të Verifikimit.
2. Përbërja dhe funksioni i Komisionit të Verifikimit rregullohen nga Rregullorja e Asamblesë së Përgjithshme e FSHF-së.

---

## **NENI 65 ORGANET GJYQËSORE**

---

1. Organet gjyqësore janë:
  - a) Komisioni i Disiplinës dhe Etikës;
  - b) Komisioni i Apelit;
  - c) Inspektorët e disiplinës;
  - d) Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve.
2. Organet gjyqësore duhet të përbëhen në mënyrë të tillë që anëtarët, së bashku, të kenë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e specializuar që është e nevojshme për realizimin e duhur të detyrave të tyre. Kryetarët dhe nënkryetarët e Komisionit të Disiplinës dhe Etikës, Komisionit të Apelit, Dhomës Kombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe të gjithë inspektorët e disiplinës duhet të jenë të kualifikuar si juristë, me më shumë se 5 vite eksperiencë profesionale.

3. Të gjithë anëtarët kanë mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhje sipas rregullave të këtij statuti.
4. Kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e tjerë të organeve gjyqësore zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Komitetit Ekzekutiv dhe nuk duhet të jenë anëtarë të asnjë organi tjetër të FSHF-së.
5. Nëse kryetari, nënkryetari ose një anëtar i një organi gjyqësor i ndërpritet kryerja e funksionit zyrtar gjatë mandatit të tij, Komiteti Ekzekutiv emëron një zëvendësues për të shërbyer deri në Asamblenë e Përgjithshme të ardhshme, ku Asambleja e Përgjithshme cakton një anëtar të ri të organit gjyqësor përkatës për mandatin e mbetur.
6. Përgjegjësitë dhe funksioni i organeve gjyqësore përcaktohen në Kodin e Disiplinës dhe Etikës të FSHF-së.

---

**NENI 66 KOMISIONI I DISIPLINËS DHE ETIKËS**

---

1. Komisioni i Disiplinës dhe Etikës përbëhet nga kryetari, një nënkryetar dhe numri i nevojshëm i anëtarëve të tjerë siç përcaktohet nga Komiteti Ekzekutiv.
2. Komisioni i Disiplinës dhe Etikës, si rregull, shqyrton çështjet në trupa gjyqësore me tre anëtarë, të emëruar nga kryetari rast pas rasti. Përrjashtimet mund të përcaktohen në Kodin e Disiplinës dhe Etikës të FSHF-së, i cili mund të parashikojë që kryetari, nënkryetari ose një anëtar që vepron si kryetar *ad hoc*, të shqyrtojë çështje të veçanta si gjyqtar i vetëm.
3. Funksioni i Komisionit të Disiplinës dhe Etikës rregullohet nga Kodi i Disiplinës dhe Etikës i FSHF-së.
4. Komisioni i Disiplinës dhe Etikës mund të japë sanksionet e përshkruara në këtë statut dhe Kodin e Disiplinës dhe Etikës të FSHF-së për anëtarët, zyrtarët, lojtarët, klubet, agjentët e licencuar të ndeshjeve dhe ndërmjetësuesit.

5. Këto dispozita nuk prekin kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme dhe Komitetit Ekzekutiv në lidhje me pezullimin dhe përjashtimin e anëtarëve.

---

## **NENI 67 KOMISIONI I APELIT**

---

1. Komisioni i Apelit përbëhet nga kryetari, një nënkryetar dhe numri i nevojshëm i anëtarëve të tjerë siç përcaktohet nga Komiteti Ekzekutiv.
2. Komisioni i Apelit, si rregull, shqyrton çështjet në trupa me tre anëtarë, të emëruar nga kryetari rast pas rasti. Kodi i Disiplinës dhe Etikës i FSHF-së mund të parashikojë përjashtime dhe, në veçanti, ngarkojë kryetarin, nënkryetarin ose një anëtar që vepron si kryetar *ad hoc*, të marrë i vetëm një vendim mbi ankesa që janë të papranueshme, të bazuara ose të pabazuara.
3. Funkzioni i Komisionit të Apelit rregullohet nga Kodi i Disiplinës dhe Etikës i FSHF-së.
4. Komisioni i Apelit është përgjegjës për trajtimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit të Verifikimit, Komisionit të Disiplinës dhe Etikës, të cilat nuk konsiderohen si përfundimtare nga rregulloret përkatëse të FSHF-së.
5. Vendimet e dhëna nga Komisioni i Apelit mund t'i referohen vetëm një gjykate arbitrazhi të pavarur dhe të krijuar siç duhet, në përputhje me parashikimet në këtë statut.

---

## **NENI 68 INSPEKTORËT E DISIPLINËS**

---

1. Asambleja e Përgjithshme zgjedh, me rekomandimin e Komitetit Ekzekutiv, numrin e nevojshëm të inspektorëve të disiplinës dhe cakton njërin prej tyre si kryeinspektor.

2. Funkzioni i inspektorëve të disiplinës mbulohet nga Kodi i Disiplinës dhe Etikës i FSHF-së; inspektorët e disiplinës përfaqësojnë FSHF-në në procedurat para Komisionit të Disiplinës dhe Etikës dhe Komisionit të Apelit.

---

## **NENI 69 DHOMA KOMBËTARE E ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE**

---

1. Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve (DHKZK) përbëhet nga kryetari, dy nënkryetarë dhe dymbëdhjetë anëtarë të tjerë. Pesë anëtarë propozohen nga Komiteti Ekzekutiv, pesë anëtarët emërohen nga përfaqësuesit e klubeve dhe pesë të tjerë nga përfaqësuesit e lojtarëve dhe trajnerëve. Kryetari dhe dy nënkryetarët zgjidhen nga përfaqësuesit e propozuar nga Komiteti Ekzekutiv. Anëtarët e emëruar nga përfaqësuesit e klubeve dhe përfaqësuesit e lojtarëve dhe trajnerëve nuk u nënshtrohen kërkesave të pavarësisë të përcaktuara në nenin 62, paragrafi 2 dhe 3, më sipër.
2. Funkcionimi i Dhomës së Zgjidhjes së Konfliktëve trajtohet nga Rregullorja e DHKZK e miratuar nga Komiteti Ekzekutiv.
3. Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve është përgjegjëse për trajtimin e mosmarrëveshjeve në nivel kombëtar midis klubeve dhe lojtarëve në lidhje me çështjet e punësimit dhe stabilitetit kontraktor dhe në aspektin e trajnimit (formimit), të shpërblimit të lojtarëve dhe kontributeve të solidaritetit midis klubeve të lidhura me FSHF-në.
4. Vendimet e marra nga Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve mund të ankimohen vetëm para një gjykate arbitrazhi të pavarur dhe të krijuar në mënyrën e duhur, në përputhje me parashikimet në këtë statut.

## VI. MASAT DISIPLINORE

---

### NENI 70 MASAT DISIPLINORE

---

Masat disiplinore janë kryesisht:

1. Për personat fizikë dhe juridikë:
  - a) paralajmërim;
  - b) vërejtje;
  - c) gjobë;
  - d) kthim i çmimeve.
2. Për personat fizikë:
  - a) vërejtje;
  - b) dëbim;
  - c) pezullim ndeshjeje;
  - d) ndalim hyrje në dhomat e zhveshjes dhe/ose në stolin e rezervave;
  - e) ndalim hyrjeje në një stadium;
  - f) ndalim nga marrja pjesë në ndonjë aktivitet të lidhur me futbollin;
  - g) punë sociale;
  - h) trajnim për pajtueshmërinë.
3. Për personat juridikë:
  - a) ndalimin e transferimit;
  - b) luajtjen e ndeshjes pa spektatorë;
  - c) luajtjen e ndeshjes në territor neutral;
  - d) ndalimin e lojës në një stadium të veçantë;
  - e) anulimin e rezultatit të ndeshjes;



- f) përjashtimin nga një garë;
- g) humbjen e ndeshjes në tavolinë;
- h) zbritjen e pikëve;
- i) kalimin në një kategori më të ulët;
- j) përsëritjen e ndeshjes.

## VII. ARBITRAZHI

---

### NENI 71 ARBITRAZHI

---

1. Mosmarrëveshjet brenda FSHF-së ose mosmarrëveshjet që prekin anëtarët e FSHF-së, ligat, anëtarët e ligave, klubet, anëtarët e klubeve, lojtarët dhe zyrtarët mund të ankimohen në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme të FSHF-së) në CAS, i cili jep zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjet duke përjashtuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, derisa të krijohet, të funksionojë dhe të njihet nga FIFA dhe UEFA një organ arbitrazhi sportiv plotësisht i pavarur, brenda rendit juridik privat sportiv në Republikën e Shqipërisë.
2. Mosmarrëveshjet e nivelit ndërkombëtar që lindin ose lidhen me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s ose UEFA-s mund të paraqiten në shkallën e fundit në CAS-it siç përcaktohet në statutin e FIFA-s dhe UEFA-s.

---

### NENI 72 JURIDIKSIONI

---

1. FSHF-ja ka juridiksion mbi mosmarrëveshjet e brendshme kombëtare, d.m.th. mosmarrëveshjet midis palëve që i përkasin ose janë të lidhura me FSHF-në.
2. FIFA dhe/ose UEFA kanë juridiksion mbi mosmarrëveshjet ndërkombëtare, d.m.th. mosmarrëveshjet midis palëve që u përkasin shoqatave dhe/ose konfederatave të ndryshme, në përputhje me rregulloret përkatëse.
3. FSHF do të sigurojë pajtueshmërinë e të gjithë subjekteve që i nënshtrohen juridiksionit të saj, me çdo vendim përfundimtar të miratuar nga një organ i FIFA-s, një organ i UEFA-s ose CAS-i.

## VIII. FINANCAT

---

### **NENI 73 PERIUDHA FINANCIARE**

---

1. Periudha financiare e FSHF-së është një vit, ajo fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
2. Të ardhurat dhe shpenzimet e FSHF-së menaxhohen në mënyrë që ato të ekuilibrohen gjatë periudhës financiare. Detyrat kryesore të FSHF-së në të ardhmen garantohen përmes krijimit të rezervave.
3. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për hartimin e pasqyrave vjetore të konsoliduara të FSHF-së me filialet e saj deri më 31 dhjetor, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

---

### **NENI 74 TË ARDHURAT**

---

Të ardhurat e FSHF-së përfshijnë:

- a) kuotat vjetore të anëtarëve;
- b) të ardhurat e krijuara nga tregtimi i të drejtave të FSHF-së;
- c) gjobat e vendosura nga organet e autorizuara;
- d) kuota dhe të ardhura të tjera në përputhje me objektivat e ndjekur nga FSHF;
- e) donacione;
- f) çdo e ardhur tjetër në lidhje me aktivitetet e futbollit;
- g) financime nga FIFA dhe nga UEFA.

---

**NENI 75 SHPENZIMET**

---

FSHF mbulon:

- a) shpenzimet e parashikuara në buxhet;
- b) shpenzime të tjera të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme dhe shpenzime që Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë të kryejë brenda fushës së kompetencave të tij;
- c) të gjitha shpenzimet e tjera në përputhje me objektivat e ndjekura nga FSHF.

---

**NENI 76 AUDITUESIT E PAVARUR DHE TË JASHTËM**

---

Audituesit e pavarur dhe të jashtëm të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme kontrollojnë çdo vit llogaritë e miratuara nga Komisioni i Financave në përputhje me parimet e duhura të kontabilitetit dhe paraqesin një raport para Asamblesë së Përgjithshme. Raporti i auditimit i kalohet Komitetit Ekzekutiv dhe duhet t'i kalohet pa ndryshime Asamblesë së Përgjithshme për miratim. Audituesit e pavarur dhe të jashtëm emërohen, me propozim të Komitetit Ekzekutiv, për një periudhë 1-vjeçare. Mandati i tyre mund të rinovohet.

---

**NENI 77 KUOTAT E ANËTARËSISË**

---

1. Kuotat e anëtarësisë për anëtarët e drejtpërdrejtë vendosen nga Asambleja e Përgjithshme dhe paguhen brenda datës 1 Qershor të çdo viti. Kuota vjetore për anëtarët e rinj për vitin në fjalë paguhet brenda 30 ditëve nga përfundimi i Asamblesë së Përgjithshme që i ka pranuar ata.
2. Asambleja e Përgjithshme përcakton shumën e kuotës vjetore çdo katër vite me rekomandimin e Komitetit Ekzekutiv. Kuota

është e njëjtë për çdo anëtar dhe do të jetë jo më shumë se 200.000 (dyqind mijë) Lekë.

---

**NENI 78 SHLYERJA**

---

FSHF mund të debitojë pasuritë dhe llogaritë e çdo anëtari për të shlyer detyrimet që ata kanë ndaj FSHF-se ose të tretëve.

---

**NENI 79 TARIFAT**

---

FSHF mund të kërkojë pagimin e një tarife për ndeshjet nga anëtarët e saj.

---

**NENI 80 BOTIMI I TË DHËNAVE FINANCIARE**

---

1. FSHF boton në faqen e saj zyrtare dokumentet financiare të përmendura në nenin 34, paragrafi 2 “i”, “j” dhe “k” të këtij statuti pasi pikat përkatëse të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Shpërblimi i anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv (përfshirë Presidentin), Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura do të bëhet rregullisht publike (p.sh. përmes botimit në faqen zyrtare të FSHF-së).

## IX. GARAT DHE TË DREJTAT NË GARA DHE NË AKTIVITETE

---

### NENE 81 GARAT

---

1. FSHF zhvillon aktivitete futbollit në Republikën e Shqipërisë përmes organizimit të ndeshjeve/garave me mbulim kombëtar, rajonal ose lokal. Struktura e garës ndërtohet gjithashtu në përputhje me cilësinë e sportit, gjininë, moshën, llojin e futbollit dhe marrëdhëniet profesionale.
2. Garat me shtrirje kombëtare janë:
  - a) Kampionati Kombëtar i Kategorisë Superiore;
  - b) Kupa e Shqipërisë;
  - c) Superkupa e Shqipërisë;
  - d) Kampionati Kombëtar i Kategorisë së Parë;
  - e) Kampionati Kombëtar i Kategorisë së Dytë;
  - f) Kampionati Kombëtar i Kategorisë së Tretë;
  - g) Kampionati Kombëtar i Kategorisë Superiore U-21; U-19; U-17, U-15; U-13
  - h) Kampionati Kombëtar i Kategorisë së Parë U-19; U-17;
  - i) Kupa e Shqipërisë U-19 dhe U-17;
  - j) Kampionati Kombëtar i Femrave;
  - k) Kupa e Shqipërisë për Femra;
  - l) Kampionati Kombëtar i Futbollit 5x5;
  - m) Kampionati Kombëtar i Futsal;
  - n) Kupa e Shqipërisë në Futsal;

- o) Kampionati Kombëtar i Futbollit në Rërë.
- 3. Garat me shtrirje rajonale janë kampionatet rajonale:  
U-19, U-17, U-15, U-13, U-11, U-9, U-7
- 4. Garat me shtrirje lokale janë:
  - a) Kampionatet e futbollit të shkollave 9-vjeçare, shkollave të mesme të përgjithshme dhe universiteteve;
  - b) Kampionatet e minifutbollit për shkollat e mesme.
- 5. Komiteti Ekzekutiv mund të shtojë ndeshje/gara që nuk parashikohen në paragrafin 2, 3 dhe 4 më sipër, dhe mund të vendosë pezullimin e përkohshëm të një ose më shumë nga garat e mësipërme.
- 6. Komiteti Ekzekutiv nxjerr rregulloret në lidhje me dhe përcakton datën dhe përfundimin e garave në paragrafin 2, 3 dhe 4 më sipër.
- 7. Komiteti Ekzekutiv mund të delegojë dhe t'i heqë ligave vartëse të FSHF-së kompetencën për të organizuar gara (p.sh. me anë të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për futbollin elitare) dhe për të nxjerrë rregulloret përkatëse. Garat e organizuara nga ligat nuk ndërhyjnë me garat e organizuara nga FSHF. Garat e organizuara nga FSHF kanë përparësi.
- 8. Çdo subjekt i interesuar për të organizuar një ose më shumë gara jashtë kalendarit të garave të miratuar nga FSHF, ose aktivitete të veçanta futbollit në Republikën e Shqipërisë, duhet së pari të marrë leje nga FSHF për këtë qëllim.

---

**NENI 82 LICENCIMI I KLUBEVE**

---

Komiteti Ekzekutiv nxjerr rregullore në lidhje me sistemin e licencimit të klubeve, i cili rregullon pjesëmarrjen e klubeve në garat e FSHF-së dhe UEFA-s, në përputhje me kërkesat minimale të sistemit të licencimit të klubeve, siç përcaktohen nga UEFA dhe FIFA.

---

**NENI 83 TË DREJTAT**

---

1. FSHF dhe anëtarët e saj janë pronarët origjinalë të të gjitha të drejtave që burojnë nga gara dhe aktivitete të tjera që kryhen nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim për sa u përket përmbajtjes, kohës dhe vendit. Këto të drejta përfshijnë, ndër të tjera, çdo lloj të drejte financiare, regjistrim audioviziv dhe radiofonik, të drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat multimediale, të drejtat e marketingut dhe promovimit dhe të drejtat jomateriale, siç janë emblemat dhe të drejtat që rrjedhin nga ligji për të drejtat e autorit.
2. Komiteti Ekzekutiv vendos se si dhe deri në çfarë mase përdoren këto të drejta dhe harton rregullore të veçanta për këtë qëllim. FSHF sigurohet që shitja e këtyre të drejtave të kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me statutin dhe rregulloret e FSHF-së, si dhe ligjet kombëtare në fuqi.

---

**NENI 84 AUTORIZIMI PËR SHPËRNDARJE**

---

1. FSHF dhe anëtarët e saj janë ekskluzivisht përgjegjës për autorizimin e shpërndarjes së imazhit dhe zërit dhe elemente të tjera të të dhënave të ndeshjeve të futbollit dhe ngjarjeve që kryhen nën juridiksionin e tyre përkatës, pa asnjë kufizim.
2. Komiteti Ekzekutiv nxjerr rregullore të veçanta për këtë qëllim.



## X. NDESHJET DHE GARAT NDËRKOMBËTARE

### NENI 85 NDESHJET DHE GARAT NDËRKOMBËTARE

1. Kompetenca për organizimin e ndeshjeve dhe garave ndërkombëtare midis ekipeve përfaqësuese dhe midis ligave, ekipeve të klubeve dhe/ose ekipeve të përkohshme i takon vetëm FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së. Asnjë ndeshje apo garë e tillë nuk do të zhvillohet pa lejen paraprake të FIFA-s, UEFA-s dhe/ose FSHF-së në përputhje me rregulloret e FIFA-s që mbulojnë ndeshjet ndërkombëtare.
2. FSHF është e detyruar të respektojë kalendarin ndërkombëtar të ndeshjeve të përpiluar nga FIFA.

### NENI 86 KONTAKTET

FSHF, anëtarët, lojtarët, zyrtarët e tij, agjentët e ndeshjeve të licencuar dhe ndërmjetësit nuk mund të luajnë ndeshje ose të realizojnë kontakte sportive me shoqata që nuk janë anëtare të FIFA-s ose anëtare të përkohshme të UEFA-s pa miratimin e FIFA-s.

### NENI 87 MIRATIMI

1. Klubet, ligat ose ndonjë grup tjetër i klubeve apo anëtarëve të lidhur me FSHF-në mund të bashkohen me një shoqatë tjetër vetëm me autorizimin e FSHF-së, dhe FIFA-s.
2. Klube, ligat ose çdo grup tjetër i klubeve që janë të lidhur me FSHF-në nuk mund të marrin pjesë në gara në territorin e një shoqate tjetër pa autorizimin e FSHF-së, FIFA-s dhe/ose UEFA-s, në përputhje me rregulloret e FIFA-s që mbulojnë ndeshjet ndërkombëtare.

## XI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

---

### **NENI 88 NGJARJE TË PAPANASHIKUARA DHE FORCA MADHORE**

---

Komiteti Ekzekutiv ka kompetencën të vendosë për të gjitha rastet e forcës madhore dhe për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë statut; vendimet e tilla do të marrin parasysh rregulloret përkatëse të FIFA-s dhe UEFA-s, si dhe çdo ligj të zbatueshëm të detyrueshëm.

---

### **NENI 89 BOTIMI I DOKUMENTEVE TË ORGANIZATËS**

---

FSHF-ja boton në faqen e saj zyrtare të internetit dokumentet dhe informacionin e mëposhtëm:

- a) Statutin dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- b) Rregulloren e Asamblesë se Përgjithshme;
- c) Kodin e Disiplinës dhe Etikës;
- d) Rregulloret e Organizimit të Brendshëm;
- e) Vendimet më të rëndësishme;
- f) Strategjinë e saj;
- g) Rendin e ditës për mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv dhe të Asamblesë së Përgjithshme;

---

### **NENI 90 SHPËRBËRJA**

---

1. Çdo vendim në lidhje me shpërbërjen e FSHF-së kërkon shumicën e dy të tretave të të gjithë anëtarëve të FSHF-së. Vendimi duhet

të merret në një Asamble të Përgjithshme të thirrur posaçërisht për këtë qëllim.

2. Nëse FSHF shpërbëhet, pas likuidimit të detyrimeve të saj, asetet e saj i transferohen UEFA-s e cila i mban këto asetet si kujdestare në përputhje me detyrat përkatëse profesioniste derisa të rikrijohet FSHF. Megjithatë, Asambleja e Përgjithshme e fundit mund të zgjedhë që asetet t'i dorëzohen një marrësi tjetër me votim prej të paktën dy të tretat e votave.

---

**NENI 91      HYRJA NË FUQI**

---

Ky statut u miratua nga Asambleja e Përgjithshme në Tiranë më 12.05.2023 dhe hyn në fuqi më 12.05.2023. Statuti i mëparshëm i FSHF-së shfuqizohet.

---

**NENI 92      DISPOZITA TRANZITORE**

---

1. Anëtarëve të FSHF siç përkufizohen në nenin 13/2 të këtij statuti, u akordohet një periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muajsh për të miratuar dispozitat e detyrueshme të nenit 14/2 si dhe nenit 17/1(h),i),k),o) dhe q) të këtij statuti. Anëtarët të cilët nuk i përmbahen këtij detyrimi, brenda periudhës së sipërcituar, nuk do të merren në konsideratë kur të llogaritet kuorumi. Anëtarët në fjalë do të ri-fitojnë të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme pasi të përmbushin detyrimin e parashikuar nga ky paragraf.
2. Detyrimi i Shoqatave Rajonale për të garantuar përfaqësim të përshtatshëm për klubet pjesëmarrëse e kampionatit kombëtar të femrave siç përcaktohet në nenin 17/1/p të këtij statuti do të abrogohet me hyrjen në fuqi të rregulloreve të licensimit që detyrojnë çdo klub profesionist të ketë një ekip femrash.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, Komisioni i Verifikimit do të përcaktojë numrin fillestar të delegatëve që i akordohen futbollit profesionist, shoqatave rajonale dhe shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin në përputhje me nenin 28/2 të këtij statuti.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, anëtarët e komisioneve të përcaktuara në nenet 47 deri 59 të këtij statuti të cilët janë aktualisht në detyrë, do të vijojnë mandatin e tyre deri në përfundim të afatit përkatës. Çdo pozicion shtesë i cili mund të duhet të plotësohet me hyrjen në fuqi të këtij statuti do të emërohet ose zgjidhet brenda një periudhe 12 mujore nga hyrja në fuqi e këtij statuti dhe deri në fund të mandatit aktual të komisioneve në fjalë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, anëtarët e komisioneve të përcaktuara në nenet 62 deri 69 të këtij statuti, të cilët janë aktualisht në detyrë do të vijojnë mandatin e tyre deri në përfundim të afatit përkatës. Çdo pozicion shtesë në komisionet e pavarura që mund të duhet të plotësohet me hyrjen në fuqi të këtij statuti do të emërohet ose zgjidhet brenda një periudhe 12 mujore nga hyrja në fuqi e këtij statuti dhe deri në fund të mandatit aktual të komisioneve në fjalë.

Tiranë më, 12.05.2023

### **Për Federatën Shqiptare të Futbollit**

**Armand DUKA**  
Presidenti

**Ilir SHULKU**  
Sekretari i Përgjithshëm

## SHTOJCA A – PYETËSOR PËR KONTROLLIN E INTEGRITETIT

### PJESA 1: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kontrollat e integritetit në lidhje me kandidatët dhe mbajtësit e pozicioneve zyrtare brenda FSHF-së që i nënshtrohen kontrolleve të tilla (“kandidatët ose mbajtësit”) kryhen nga organi përkatës në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe kësaj shtojce.
2. Kandidatët ose mbajtësit janë të detyruar të respektojnë procesin e shqyrtimit dhe vetëdeklarimit, siç përshkruhet në pjesët 2 dhe 3 më poshtë. Para procesit të kontrollit, çdo kandidat ose mbajtës duhet të japë pëlqimin e tij me shkrim për procesin në fjalë përmes një formulari të ofruar nga organi përkatës që kryen kontrollin e integritetit. Nëse nuk jepet një pëlqim i tillë me shkrim, kandidati ose mbajtësi i pozicionit do të konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e integritetit.
3. Kandidatët ose mbajtësit e pozicionit duhet të veprojnë me mirëbesim në çdo kohë dhe do të bashkëpunojnë plotësisht për të vërtetuar faktet përkatëse pas një njoftim të arsyeshëm. Nëse kandidati ose mbajtësi i pozicionit përkatës nuk bashkëpunon me organin kompetent për të kryer kontrollin e integritetit, kandidati ose mbajtësi i pozicionit do të konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e integritetit.
4. Kandidati ose mbajtësi i pozicionit konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e integritetit, nëse ai:
  - a) ka qenë objekt i dënimeve penale ose sanksioneve disiplinore nga një gjykatë kombëtare, veçanërisht nëse vepra në fjalë ka qenë çështje thelbësore dhe jo një shkelje e vogël ose sjellje e pahijshme procedurale;

- b) është shpallur fajtor dhe/ose është dënuar nga Komisioni i Etikës i FIFA-s ose ndonjë organ tjetër sportiv me një sanksion që do të vinte seriozisht në pikëpyetje realizimin e detyrës në fjalë.
5. Në varësi të dispozitave përkatëse në lidhje me zbulimin dhe përcjelljen e informacionit dhe të dhënave përkatëse të marra në kontekstin e kontrolleve të integritetit në përputhje me këtë shtojcë, të gjitha informacionet e tilla dhe të dhënat e lidhura me to duhet të trajtohen si rreptësisht konfidenciale nga organi që kryen kontrollin e integritetit në fjalë.

---

## **PJESA 2: PROCESI I SHQYRTIMIT**

---

1. Në fillim të procesit të shqyrtimit, secili kandidat ose mbajtës i një detyre duhet t'i nënshtrohet kontrollit të identifikimi ("Kontrolli i ID-së"). Në këtë kuadër, kandidati ose mbajtësi i pozicionit duhet t'i paraqesë një kopje të vlefshme të pasaportës organit përgjegjës për kryerjen e kontrollit të integritetit. Kontrolli i ID-së përfshin verifikimin/identifikimin e elementeve të mëposhtëm:
- a) emrin dhe mbiemrin;
  - b) adresën e banimit;
  - c) datën dhe vendin e lindjes;
  - d) shtetësinë.
2. Çdo kandidat ose mbajtës i pozicionit duhet të plotësojë pyetëSORIN që jepet në pjesën 3, më poshtë.
3. Organi përgjegjës për kryerjen e kontrollit të integritetit mund të kryejë kërkime të pavarura dhe/ose hetime në mënyrë që të marrë informacione të mëtejshme të rëndësishme për një kandidat ose mbajtës të një pozicioni të caktuar, i cili mund të përfshijë informacione për ndërmjetësuesit dhe palët e lidhura, mandatet, konfliktet e mundshme të interesit dhe informacione për pjesëmarrjet, si dhe procedime/hetimet civile dhe penale.

**PJESA 3: PYETËSOR**

Emri:	
Mbiemri:	
Adresa e banimit:	
Data dhe vendi i lindjes:	
Shtetësia/shtetësitë:	
Profesioni:	

1. A jeni dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për ndonjë veprë të qëllimshme të dënueshme, ose për ndonjë veprë që përkon me shkeljen e rregullave të sjelljes të përcaktuara në pjesën II seksioni 5 i Kodit të Etikës të FIFA-s?

Jo  Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

2. A ka vendosur ndonjëherë një organ drejtues sportiv ndonjë sanksion ose masë disiplinore, ose të ngjashme, ndaj jush në të shkuarën për veprime që përbëjnë shkelje të rregullave të sjelljes të përcaktuara në pjesën II seksioni 5 i Kodit të Etikës të FIFA-s?

Jo  Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

3. A jeni subjekt i ndonjë procedure civile, penale ose disiplinore ose hetimi penal?

Jo

Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

---

4. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm që i nënshtrohem dispozitave të Kodit të Disiplinës dhe Etikës të FSHF-së dhe dispozitave të statuteve dhe rregulloreve të tjera të FSHF-së që mund të trajtojnë çështje të integritetit dhe unë i përmbush plotësisht këto dispozita.

5. Unë mbaj aktualisht pozicionet e mëposhtme në futboll: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_.

6. Faktet dhe rrethanat e mëposhtme mund të çojnë në konflikte të mundshme interesi në lidhje me mua (në veçanti neni 23, paragrafi 9 i këtij statuti):

---

7. Vërejtje dhe vëzhgime të cilat mund të jenë me rëndësi të mundshme në kuadrin e kontrollit të integritetit:

---

8. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe bie dakord që ky pyetësor t'u vihet në dispozicion anëtarëve të organit përkatës të FSHF-së.

9. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që duhet të njoftoj organin që kryen kontrollin e integritetit për çdo fakt dhe rrethanë



të rëndësishme që mund të dalë pasi të ketë përfunduar kontrolli i integritetit.

10. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që jam i detyruar të bashkëpunoj plotësisht për të vërtetuar faktet përkatëse në lidhje me kontrollin e integritetit të cilit po i nënshtrohem. Në veçanti, pajtohem me kërkesat për çdo dokument, informacion ose ndonjë material tjetër të çfarëdo natyre të mbajtur nga unë. Përveç kësaj, unë do të veproj në përputhje me kërkesën për të vënë në dispozicion dhe ofruar dokumente, informacione ose çdo material tjetër të çfarëdo natyre që nuk mbahet nga unë, por që unë kam të drejtë të marr.
  
11. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që organi që kryen kontrollin e integritetit gjithashtu mund të kërkojë informacion mbi sanksionet e mundshme (pyetjet 1 dhe 2 më sipër) në mënyrë të drejtpërdrejtë nga FIFA ose konfederata përkatëse si dhe nga institucione të tjera, të tilla si Gjykata e Arbitrazhit për Sportin në Lozanë, Zvicër, ose Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Në këtë drejtim, unë i liroj institucionet përkatëse nga çdo detyrim konfidencialiteti në lidhje me informacionin në fjalë.
  
12. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që organi që kryen kontrollin e integritetit mund të mbledhë informacione të mëtejshme për mua në përputhje me pjesën 2, paragrafi 3 i kësaj shtojce.

---

(data dhe vendi)

---

(nënshkrimi)

# SHTOJCA B

## RREGULLORE E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT (FSHF)

### PËRKUFIZIME

Kurdoherë që është e nevojshme, terminologjia e përdorur në Kjo Rregullore i referohet termave të përcaktuar në seksionin e Përkufizimeve në Statutin e FSHF.

NB: Termat të cilat i referohen personit fizik janë të zbatueshme për të dyja gjinitë. Çdo term në njëjës nënkupton dhe zbatohet edhe në shumës dhe anasjelltas.

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### NENI 1 FUSHA E ZBATIMIT

- 1 Kjo Rregullore është e zbatueshme për Asamblenë dhe për zgjedhjet e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe komisioneve të pavarura siç përcaktohet në Statutin e FSHF.
- 2 Kjo Rregullore është gjithashtu e zbatueshme për zgjedhjet e anëtarëve të organeve përkatëse të shoqatave rajonale dhe shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin, nëse Statuti i tyre e parashikon në mënyrë specifike këtë. Statutet e shoqatave rajonale dhe shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin përcaktojnë fushën e saktë të zbatimit të kësaj rregullore dhe veçanërisht nëse Komisioni i Verifikimit luan rolin e mbikëqyrësit të procesit zgjedhor përkatës.

#### NENI 2 PARIMET DHE DETYRIMET

- 1 Kjo Rregullore synon të sigurojë një zhvillim të qetë dhe korrekt të

Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së duke mbrojtur detyrimet e të gjitha palëve të përfshira.

- 2 Parimet e përgjithshme të qeverisjes së mirë, të tilla si ndarja e pushteteve, pavarësia, transparenca dhe detyrimi për të shmangur situatat e konfliktit të interesit do të respektohen pa përjashtim përgjatë gjithë procesit zgjedhor ose të Asamblesë.
- 3 Ndikimi i padrejtë nga palët e treta në procesin zgjedhor është i ndaluar. FSHF informon menjëherë FIFA-n dhe UEFA-n për çdo ndikim të padrejtë nga palët e treta në procesin zgjedhor.
- 4 FSHF siguron që çdo proces zgjedhor i organeve në varësi të saj është në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore, me Statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s.
- 5 FSHF, të paktën 30 ditë para datës së zgjedhjeve përkatëse, informon FIFA-n dhe UEFA-n për natyrën e zgjedhjeve që priten të mbahen (p.sh. numrin e anëtarëve që do të zgjidhen, kohëzgjatjen e mandateve, arsyen e zhvillimit të zgjedhjeve, etj.) dhe siguron për FIFA-n dhe UEFA-n një kopje të Rregullores në fuqi dhe, nëse është e zbatueshme, çdo rregullore dhe udhëzim tjetër zgjedhor.
- 6 Në qoftë se nuk parashikohet ndryshe në Statutin dhe rregulloret e FSHF, anëtarët e organeve përkatëse të FSHF-së do të vijojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në përfundimin e procesit zgjedhor. Mandatet përkatëse të organeve të sapo zgjedhura fillojnë pas përfundimit të Asamblesë nëpërmjet së cilës ata zgjidhen.

## II. PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

### NENI 3 PËRFAQËSIMI

1. Shoqatat Rajonale sigurojnë përfaqësimin e duhur midis anëtarëve të tyre duke shpërndarë numrin e delegatëve që iu atribuohen atyre nga Komisioni i Verifikimit në 4 (katër) kritere, duke përdorur metodën e mëposhtme:

- Një (1) delegat për çdo 1000 lojtarë të licencuar që marrin pjesë në garat rajonale të të gjitha niveleve;
- Një (1) delegat për çdo dy (2) klube që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Dytë;
- Një (1) delegat për çdo tre (3) klube që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Tretë;
- Një (1) delegat për çdo dy (2) klube të femrave që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Femrave;

Në rast se Komisioni i Verifikimit e korrekton numrin e delegatëve për shoqatat rajonale bazuar në Nenin 28 paragrafi 2 të Statutit, atëherë Komisioni i Verifikimit do të përshtatë kriteret e mësipërme duke ruajtur raportin midis 4 (katër) pjesëve.

- 2 Shpenzimet e udhëtimit të delegatëve dhe/ose shpenzimet e akomodimit mbulohen nga Anëtari me anëtarësi të drejtpërdrejtë.

### III. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ASAMBLESË

---

#### NENI 4 DREJTUESI I ASAMBLESË

---

- 1 Asambleja drejtohet nga Presidenti i FSHF-së. Në rast të mungesës së tij, Asambleja drejtohet nga zv/Presidenti i parë dhe në mungesë të tij nga zv/Presidenti i dytë. Nëse edhe ky i fundit nuk mund të marrë pjesë, Asambleja cakton një anëtar të Komitetit Ekzekutiv si Drejtues. Gjatë zgjedhjes së Presidentit dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv, Asamblenë e kryeson Kryetari i Komisionit të Verifikimit.
- 2 Drejtuesi i Asamblesë siguron që të ndiqen rregullat e procedurave. Ai është kompetent për çeljen dhe mbylljen e punimeve të Asamblesë. Ai procedon sipas rendit të ditës dhe i jep fjalën delegatëve dhe/ose të ftuarve.
- 3 Drejtuesi mban rregull në Asamble. Ai mund të marrë masat e mëposhtme kundrejt pjesëmarrësve që ndërpresin procedurat:

- a) kërkon vendosjen e qetësisë;
- b) qorton;
- c) përjashton nga Asambleja.

---

**NENI 5            SEKRETARIATI**

---

Sekretari i Përgjithshëm dhe vëzhguesit përbëjnë Sekretariatit e Asamblesë.

---

**NENI 6            RENDI I DITËS**

---

- 1 Rendi i ditës miratohet në fillim të Asamblesë.
- 2 Rendi i ditës i një Asambleje të Zakonshme mund të ndryshohet në çdo moment gjatë Asamblesë, me kusht që dy të tretat e delegatëve të pranishëm në Asamble, dhe me të drejtë vote, të bien dakord për këtë mocion. Rendi i ditës i një Asambleje të Jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet.
- 3 Asambleja nuk mund të marrë në konsideratë një propozim për të ndryshuar Statutin nëse nuk përfshihet si pikë diskutimi në rendin e ditës të dërguar me njoftimin e Asamblesë.

---

**NENI 7            DISKUTIMI**

---

- 1 Çdo pikë e rendit të ditës prezantohet me një raport të shkurtër:
  - a) nga Drejtuesi ose një anëtar i Komitetit Ekzekutiv;
  - b) nga një përfaqësues i caktuar për këtë qëllim nga një Komision;
  - c) nga Anëtari me anëtarësim të drejtpërdrejtë, i cili e ka përfshirë çështjen në fjalë në rendin e ditës.
- 2 Kjo pikë hapet më pas për diskutim të përgjithshëm.

---

**NENI 8 LEJA PËR TË MARRË FJALËN**

---

- 1 Deleгатëve u jepet leja për të marrë fjalën sipas radhës që është bërë kërkesa. Një folës nuk mund ta marrë fjalën nëse nuk i është dhënë leja për ta bërë këtë. Folësi flet nga vendi i përcaktuar për këtë qëllim.
- 2 Një folësi mund t'i jepet fjala për herë të dytë për të njëjtën çështje vetëm kur të gjithë Deleгатët e tjerë që kanë kërkuar të marrin fjalën kanë pasur një mundësi për të folur për çështjen në fjalë.
- 3 Drejtuesi mund të caktojë një afat kohor për folësit.

---

**NENI 9 MOCION PËR ÇËSHTJE PROCEDURALE**

---

- 1 Një mocion për çështje procedurale trajtohet menjëherë. Çdo diskutim tjetër pezullohet menjëherë.
- 2 Nëse miratohet një mocion për çështje procedurale, u jepet fjala vetëm Deleгатëve, të cilët e kanë kërkuar të bëjnë mocionin para votimit.
- 3 Drejtuesi vendos kur do të mbyllë diskutimin, përveç nëse më shumë se gjysma e Anëtarëve me anëtarësi të drejtpërdrejtë të pranishëm dhe me të drejtë vote, votojnë për të kundërtën.

---

**NENI 10 MOCIONET, MOCIONET PËR NDRYSHIMIN E PIKAVE TË RENDIT DHE MOCIONET PËR FSHIRJEN E PIKAVE TË RENDIT**

---

Të gjitha mocionet, mocionet për ndryshimin dhe fshirjen e pikave të rendit të ditës bëhen me shkrim.

---

**NENI 11 VOTIMI**


---

- 1 Votimi është i hapur, përveç nëse vendoset ndryshe nga Asambleja.
- 2 Votimi bëhet duke ngritur dorën (kartën e votimit) ose me anë të një numërimi elektronik.
- 3 Nëse votimi bëhet me apel, Sekretariati i Asamblesë numëron votat dhe vërteton rezultatin.
- 4 Askush nuk detyrohet të votojë.
- 5 Para çdo votimi, Drejtuesi, ose një person i caktuar prej tij për këtë qëllim, lexon propozimin dhe i shpjegon Asamblesë procedurën e votimit.
- 6 Propozimet normalisht votohen sipas radhës në të cilën vendosen në diskutim.
- 7 Një propozim për të ndryshuar një amendim të propozuar votohet përpara këtij amendimi. Një amendim i propozuar votohet përpara propozimit fillestar.
- 8 Propozimet që nuk kundërshtohen do të konsiderohen të miratuara.
- 9 Drejtuesi bindet dhe shpall rezultatin e votimit, nëse është e nevojshme pasi Sekretariati i Asamblesë vërteton rezultatet.
- 10 Askujt nuk mund t'i jepet fjala gjatë votimit ose derisa të shpallet rezultati i një vote.

---

**NENI 12 MBAJTJA E SEANCËS NË MËNYRË PUBLIKE**


---

- 1 Komiteti Ekzekutiv mund të vendosë ta mbajë Asamblenë publikisht.
- 2 Media mund të ftohen të marrin pjesë në Asamble.

---

**NENI 13 RRETHANA TË JASHTËZAKONSHME**

---

- 1 Në rast të forcave madhore ose rrethanave të jashtëzakonshme, Komiteti Ekzekutiv mund të vendosë ta mbajë Asamblenë përmes video-konferencës ose ndonjë mjeti tjetër të ngjashëm të komunikimit që lejon që delegatët të shohin dhe dëgjojnë njëri-tjetrin njëkohësisht. Në këtë rast, Komisioni i Verifikimit zbaton një sistem elektronik të votimit (i) duke garantuar që, kur është e zbatueshme, të respektohet fshehtësia e votës dhe e zgjedhjeve dhe (ii) të zëvendësojë rregullat për fletët e votimit, siç përcaktohet në nenin 22 ff të Rregullores.
- 2 Nënshkrimet elektronike pranohen gjatë Asambleve të mbajtura virtualisht.

#### IV. KOMISIONI I VERIFIKIMIT

---

**NENI 14 PARIMET E PËRGJITHSHME**

---

1. Komisioni i Verifikimit:
  - a) vendos numrin e delegatëve të caktuar për Futbollin Profesionist, shoqatat rajonale dhe shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin;
  - b) mbikëqyr Asamblenë;
  - c) organizon dhe mbikëqyr procesin zgjedhor; dhe
  - d) kryen kontrole të integritetit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit dhe kësaj Rregulloreje.
- 2 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë organi tjetër të FSHF-së dhe nuk mund të mbajnë ndonjë pozicion ekzekutiv në ndonjë organ qeveritar. Anëtarët e Komisionit të Verifikimit nuk mund të jenë kandidatë për ndonjë



- nga pozicionet që duhet të plotësohen brenda FSHF-së për sa kohë që ata janë ende nën mandat si anëtarë.
- 3 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit tërhiqen menjëherë nga çështja në proces dhe kufizohen nga marrja e ndonjë vendimi nëse:
    - a) ata janë pjesëtarë të rrethit të ngushtë familjar i njërit prej kandidatëve që garojnë për ndonjë nga pozicionet që do të plotësohen;
    - b) kur ekziston një rrezik ose mundësi e një konflikti interesi siç përcaktohet në Kodin Disiplinës dhe të Etikës të FSHF.
  - 4 Në rast se një anëtar i Komisionit të Verifikimit nuk plotëson ndonjë nga kërkesat e mësipërme dhe/ose duhet të tërhiqet nga pozicioni si anëtar i Komisionit të Verifikimit për ndonjë arsye, ai zëvendësohet në përputhje me dispozitat e parashikuara në Nenin 4 paragrafi 3 i këtyre Rregulloreve.
  - 5 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit emërohen nga Asambleja, në përputhje me dispozitat e Statutit të FSHF-së, për një mandat prej 2 (dy) vjetësh.
  - 6 Asnjë anëtar i Komisionit të Verifikimit nuk do të shërbejë për më shumë se dy mandate, qoftë dy mandate të njëpasnjëshme ose jo.
  - 7 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit veprojnë me mirëbesim në çdo kohë dhe veprojnë me paanshmëri të theksuar kur kryejnë detyrat e tyre.

---

**NENI 15 PËRBËRJA**

---

- 1 Komisioni i Verifikimit ka përbërjen e mëposhtme:
  - a) një kryetar; dhe
  - b) dy anëtarë të zakonshëm, njëri prej të cilëve emërohet nënkryetar.

- 2 Asambleja emëron gjithashtu numrin e duhur të zëvendësuesve.
- 3 Nëse kryetari mungon ose nuk është i disponueshëm, zëvendës-kryetari vepron në cilësi të tij, dhe nëse edhe ai mungon ose nuk është i disponueshëm, atëherë një anëtar i zakonshëm vepron si zëvendësues në cilësinë e tyre. Çdo anëtar i zakonshëm që mungon ose është i padisponueshëm do të zëvendësohet nga një zëvendësues.
- 4 Kryetari emëron një nga anëtarët e Komisionit të Verifikimit si sekretar, i cili do të jetë përgjegjës për çështjet përkatëse logjistike dhe administrative. Ai mund të thërrasë sekretarinë e përgjithshme për ta ndihmuar atë në përmbushjen e detyrave të tij.
- 5 Kryetari i Komisionit të Verifikimit duhet të ketë kualifikim si Jurist.
- 6 Çdo anëtar i Komisionit të Verifikimit nënshkruan një deklaratë se ata vetë i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Nenin 32 paragrafi 8 të Statutit, kërkesat e pavarësisë të përcaktuara në Nenin 62 paragrafi 3 të Statutit dhe kërkesat e integritetit të përcaktuara në Nenin 62 paragrafi 4 të këtij Statuti.

---

## **NENI 16 DETYRAT E KOMISIONIT TË VERIFIKIMIT**

---

Komisioni i Verifikimit është përgjegjës për caktimin e delegatëve të Futbollit Profesionist, shoqatave rajonale dhe palëve të interesuara për futbollin, mbikëqyrjen e Asamblesë, organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve që do të zhvillohen gjatë Asamblesë. Në veçanti, Komisioni i Verifikimit është përgjegjës për:

- a) zbatimin në mënyrë rigoroze të Statuteve dhe rregulloreve të FSHF, si edhe të kësaj Rregulloreje;
- b) FSHF siguron që çdo rregullore dhe udhëzim zgjedhor i organeve në varësi të saj është në përputhje me dispozitat e Statuteve dhe këtyre Rregulloreve si dhe me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s.

- c) zbatimin me përpikëri të afateve ligjore të zgjedhjeve;
- d) sigurimin e informacionit për anëtarët me anëtarësim të drejtpërdrejtë, si dhe për autoritetet përkatëse qeveritare (kur është e nevojshme), mediat dhe publikun, sidomos duke mbajtur një konferencë mediatike (kur është e nevojshme);
- e) kur është e nevojshme, menaxhimin e marrëdhënieve me autoritetet përkatëse qeveritare;
- f) procedurën e kandidimit (fillimi, shpërndarja e informacionit, vlerësimi, publikimi i listës zyrtare, etj.);
- g) përcaktimin dhe rregullimin e numrit të delegatëve të caktuar për Futbollin Profesional, federatat rajonale dhe palët e interesuara për futbollin, të ndihmuar nga sekretariati i përgjithshëm, në përputhje me Statutin dhe Kjo Rregullore;
- h) verifikimin e identitetit të votuesve (delegatëve) dhe kompetencat e tyre të përfaqësimit;
- i) monitorimin e procedurave zgjedhore dhe të votimit, duke përfshirë marrjen e çdo vendimi në lidhje me vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e fletëve të votimit, miratimin e një vendimi përfundimtar për çdo çështje që ka të bëjë me procedurën zgjedhore gjatë Asamblesë Zgjedhore dhe vërtetimin e rezultateve zyrtare;
- j) kryerjen e kontrolleve në lidhje me përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, pavarësisë dhe kërkesave të integritetit të përcaktuara në Statute.
- k) çdo dhe të gjitha detyrat e tjera për të siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

---

**ENI 17 MBLEDHJET, KUORUMI DHE VENDIMET**

---

- 1 Kryetari thërret mbledhjet e Komisionit të Verifikimit. Vetëm një Komision i Verifikimit i organizuar në mënyrën e duhur ka autoritetin për të gjykuar dhe për të marrë vendime.

- 2 Komisioni i Verifikimit nuk mund të mbajë një mbledhje të vlefshme përveç nëse një shumicë (më shumë se 50%) e anëtarëve të tij është e pranishme.
- 3 Komisioni i Verifikimit do të marrë vendimet e tij me shumicën (më shumë se 50%) të votave të vlefshme të hedhura. Abstenimet nuk lejohet. Nuk lejohet votimi me prokurë ose me korrespondencë. Në rast barazimi të votave, kryetari gëzon të drejtën e votës vendimtare.
- 4 Vendimet e marra regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga kryetari dhe nga sekretari i Komisionit të Verifikimit.

## V. KANDIDATURAT

---

### NENI 18 KRITERET E PËRZGJEDHJES

---

- 1 Kriteret e përzgjedhjes për pozicionet që duhet të plotësohen brenda organeve përkatëse të FSHF-së janë të parashikuara në dispozitat përkatëse të Statuteve.
- 2 Komisioni i Verifikimit nuk do të vendosë ndonjë kriter të përzgjedhjes që nuk parashikohet në Statutin ose ndonjë kriter tjetër zyrtar që nuk parashikohet në Statute ose në këtë Rregullore. Komisioni i Verifikimit do të kërkojë vetëm dokumentet që ndihmojnë të përcaktohet nëse kriteret përkatëse të përzgjedhjes janë përmbushur.
- 3 Komisioni i Verifikimit publikon listën e plotë të kriterëve të përzgjedhjes (duke iu referuar dispozitave përkatëse të Statuteve, si dhe dokumenteve që do të paraqiten për secilin nga pozicionet brenda afateve të parashikuara në Statutin e FSHF-së.

---

## NENI 19      PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I KANDIDATURAVE PËR NË KOMITETIN EKZEKUTIV

---

- 1    Asnjë tarifë ose pagesë e çfarëdo lloji nuk do të kërkohet nga asnjë prej kandidatëve në asnjë moment gjatë gjithë procedurës zgjedhore, përveç rasteve kur janë miratuar më parë nga Asambleja. Në çdo rast, çdo tarifë ose pagesë e rënë dakord do të jetë në nivele të arsyeshme dhe do të shërbejë vetëm për të mbuluar kostot e shpenzimeve përkatëse administrative.
- 2    Kandidaturat për cilindo nga pozicionet e Komitetit Ekzekutiv dërgohen me postë të regjistruar, me postë elektronike të konfirmuar nga marrësi, ose dorëzohen dorazi në këmbim të konfirmimit të marrjes, në sekretarinë e përgjithshme të paktën 20 ditë para organizimit të Asamblesë zgjedhore. Kandidaturat e marra nga sekretariati i përgjithshëm i dërgohen menjëherë sekretarit të Komisionit të Verifikimit për kontrollet përkatëse të përzgjedhjes dhe integritetit të cilat do të kryhen sipas Shtojcës A të Statutit.
- 3    Brenda 3 (tre) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e kandidatëve, Komisioni i Verifikimit informon me shkrim ata kandidatë që nuk kanë arritur të japin të gjitha dokumentet përkatëse në mbështetje të kandidatëve të tyre dhe u jep atyre dy (2) ditë të tjera për të përfunduar aplikimet. Nëse kandidatët përkatës nuk arrijnë të plotësojnë aplikimet brenda afatit të përcaktuar, kandidaturat e tyre deklarohen të pavlefshme. Ky paragraf nuk zbatohet për shprehjet e mbështetjes të parashikuara në Nenin 32 paragrafi 4 i Statutit, të cilat duhet të paraqiten brenda afatit të fundit për dorëzimin e kandidatëve për Komitetin Ekzekutiv.
- 4    Kandidaturat për Komitetin Ekzekutiv shqyrtohen nga Komisioni i Verifikimit brenda pesë (5) ditëve nga marrja e plotë të aplikimit dhe kandidatët informohen për vendimin e Komisionit të Verifikimit brenda kësaj periudhe.

---

**NENI 20            PROCEDURA E ANKIMIT PËR KANDIDATËT  
PËR NË KOMITETIN EKZEKUTIV**

---

- 1 Ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Verifikimit mund të paraqiten vetëm në Komisionin e Apelit, duke përjashtuar kështu mundësinë e apelimit të vendimeve të përmendura para çdo organi tjetër, veçanërisht një organi qeveritar.
- 2 Çdo ankim, i arsyetuar dërgohet me postë të regjistruar, ose dorëzohet në këmbim të konfirmimit të marrjes, në Sekretariatin e Përgjithshëm brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e vendimit të Komisionit të Verifikimit. Ankimet e marra nga sekretariati i përgjithshëm u dërgohen menjëherë anëtarëve të Komisionit të Apelit.
- 3 Komisioni i Apelit mund të vendosë të pranojë prova dhe dokumente të reja që nuk janë ofruar nga kandidati përkatës së bashku me kandidaturën fillestare.
- 4 Ankimi shqyrtohet nga Komisioni i Apelit brenda dy ditëve nga marrja e tyre dhe u komunikohen aplikaknteve brenda kësaj periudhe.
- 5 Ankimet pranohen, rrëzohen ose deklarohen të papranueshme nga Komisioni i Apelit. Në rast se ankimi miratohet, Komisioni i Apelit merr një vendim duke zëvendësuar vendimin e Komisionit të Verifikimit.
- 6 Vendimet e Komisionit të Apelit janë përfundimtare dhe të detyrueshme për t`u zbatuar.

---

**NENI 21            PROCEDURA PËR KANDIDATËT PËR ORGANET  
E TJERA TË FSHF-SË**

---

- 1 Kandidaturat për pozicionet e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisionet të pavarura, d.m.th. Komisioni i Auditit,

Komisioni i Verifikimit dhe organet gjyqësore) dërgohen nga Komiteti Ekzekutiv pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të paktën 20 (njëzet) ditë përpara Asamblesë përkatëse zgjedhore. Kandidaturat e marra nga sekretariati i përgjithshëm i dërgohen menjëherë Komisionit të Verifikimit për të kryer kontrollet përkatëse të përzgjedhjes, pavarësisë dhe integritetit (kur është e nevojshme). Komisioni i Verifikimit zbaton nenin 4 paragrafi 6 i këtyre Rregulloreve.

- 2 Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kandidaturave, Komisioni i Verifikimit i konfirmon sekretarisë së përgjithshme nëse janë përmbushur kërkesat për pozicionet përkatëse. Në rast se një ose më shumë kandidatë nuk mund të konsiderohen të përshtatshëm, Komiteti Ekzekutiv propozon kandidatë shtesë për pozicionet përkatëse.

---

## **NENI 22 LISTA ZYRTARE E KANDIDATËVE**

---

Lista zyrtare e kandidatëve botohet gjithashtu në faqen e internetit të FSHF-së dhe, kur është e nevojshme, u dërgohet autoriteteve përkatëse qeveritare për informacion.

## **IV. PROCEDURA E VOTIMIT**

---

### **NENI 23 FLETËT E VOTIMIT**

---

- 1 Sekretariati i përgjithshëm prodhon fletët e votimit nën mbikëqyrjen e Komisionit të Verifikimit. Fletët e votimit printohen të qarta dhe të lexueshme. Fletët e votimit mund të jenë në formën e një liste të kandidatëve për zgjedhjet që zhvillohen në bllok.
- 2 Fletët e votimit janë me ngjyra të ndryshme për secilin raund të zgjedhjeve.

---

**NENI 24 KUTIA E VOTIMIT**

---

- 1 Para fillimit të procedurës së votimit, kutia e votimit, e cila është transparente nëse është e mundur, hapet dhe u paraqitet delegatëve të Asamblesë. Kutia e votimit mbyllet dhe vendoset në një vend të dukshëm afër anëtarëve të Komisionit të Verifikimit.
- 2 Gjatë gjithë procesit të votimit, kutia monitorohet nga një prej anëtarëve të Komisionit të Verifikimit.

---

**NENI 25 HEDHJA E VOTAVE**

---

- 1 Para se delegatëve t'u kërkohet të votojnë, kryetari i Komisionit të Verifikimit shpjegon hollësisht procedurën zgjedhore (kutinë e votimit, fletët e votimit, fletët e vlefshme dhe të pavlefshme të votimit, numërimin, shumicat e kërkuara, rezultatet, etj) dhe iu referohet dispozitave statutore përkatëse.
- 2 Zgjedhjet e Presidentit dhe anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv zhvillohen si më poshtë:
  - a) Kryetari i Komisionit të Verifikimit thërret me radhë secilin delegat të pranishëm dhe me të drejtë vote që të shkojë në pjesën e përparme të sallës së Asamblesë ku zhvillohen zgjedhjet.
  - b) Pasi të thirret, i deleguari përkatës shkon në pjesën e përparme të sallës së Asamblesë dhe, pasi nënshkruan vërtetimin e fletës së votimit, merr fletën e votimit.
  - c) Delegati më pas plotëson fletën e tij të votimit në kabinën e votimit të caktuar për këtë qëllim. Kabina e votimit vendoset në një vend të dukshëm, por gjithsesi lejon që i deleguari të votojë në mënyrë të fshehtë. Asnjë celular, kamerë ose ndonjë pajisje tjetër regjistruese nuk lejohet në kabinën e votimit; dhe



- d) Më pas delegati depoziton fletën e votimit në kutinë e votimit, nënshkruan regjistrin zgjedhor dhe kthehet në vendin e tij.
- 3 Zgjedhjet e kandidatëve të organeve të tjera të FSHF-së zhvillohen si më poshtë: Delegatët qëndrojnë në vendet e tyre dhe hedhin votën duke përdorur një kuti votimi të lëvizshme që kalohet nga një vend në tjetrin nga një nga kontrollorët dhe mbikëqyret nga afër nga një anëtar i Komisionit të Verifikimit.
- 4 Procedura e numërimit fillon sapo të gjithë delegatët të kenë depozituar fletët e votimit në kutinë e votimit ose në kutinë e lëvizshme të votimit. Një anëtar i Komisionit të Verifikimit hap kutinë e votimit/kutinë e lëvizshme të votimit dhe nxjerr fletët e votimit para të gjithë delegatëve.
- 5 Më pas fillon numërim.

## VII. NUMËRIMI

### **NENI 26 PARIMET E PËRGJITHSHME**

- 1 Vetëm anëtarët e Sekretariatit të Asamblesë dhe të Komisionit të Verifikimit marrin pjesë në numërimin e fletëve të votimit. Të gjitha veprimet (hapja e kutisë së votimit, numërimi i fletëve të votimit, numërimi i votave, etj.) kryhen në mënyrë të tillë që të ndiqet qartë nga të gjithë delegatët e Asamblesë.
- 2 Në rast të një mosmarrëveshjeje në lidhje me vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e një fletë votimi ose të një vote, hartimin e procesverbalit, deklarimin e rezultateve ose ndonjë çështje tjetër në lidhje me procedurën e numërimit, vendimi i Komisionit të Verifikimit është përfundimtar.

---

**NENI 27 FLETËT E PAVLEFSHME TË VOTIMIT**

---

- 1 Fletët e votimit si më poshtë konsiderohen të pavlefshme:
  - a) fletët e votimit që nuk përmbajnë shenjat dalluese zyrtare të përcaktuara nga Komisioni i Verifikimit;
  - b) fletët e votimit që përmbajnë ndonjë fjalë tjetër përveç emrave të kandidatëve;
  - c) fletët e votimit të palexueshme ose të dëmtuara;
  - d) fletët e votimit që mbajnë shenja identifikuese.
- 2 Kryetari i Komisionit të Verifikimit shkruan në pjesën e pasme të çdo flete votimi të pavlefshme arsyen e pavlefshmërisë së fletës dhe e konfirmon me një nënshkrim.

---

**NENI 28 GABIMET DREJTSHKRIMORE**

---

Gabimet drejtshkrimore shkaktojnë pavlefshmërinë e një flete të vetme votimi nëse për shkak të tyre, nuk është e mundur të identifikohet ndonjë nga kandidatët zyrtarë.

---

**NENI 29 NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATIT**

---

- 1 Pasi të jetë hapur kutia e votimit, anëtarët e Komisionit të Verifikimit do të numërojnë numrin e fletëve të votimit dhe do të verifikojnë vlefshmërinë e tyre. Nëse numri i fletëve të votimit është i barabartë ose më i vogël se numri i fletëve të votimit të lëshuara, votimi do të konsiderohet i vlefshëm. Nëse tejkalohet numri i fletëve të votimit të lëshuara, votimi shpallet i pavlefshëm dhe do të përsëritet menjëherë në përputhje me procedurën e përshkruar më sipër.

- 2 Pasi të jetë verifikuar numri i fletëve të votimit, anëtarët e Sekretariatit të Asamblesë dhe të Komisionit të Verifikimit vazhdojnë të numërojnë numrin e votave të hedhura për secilin kandidat ose listë.
- 3 Nëse kërkohet një raund i dytë (ose pasardhës) votimi, procedura e votimit përsëritet në përputhje me nenet e mësipërme. Delegatët gjithashtu duhet të informohen për dispozitat ligjore që zbatohen për raundet e dyta (dhe pasuese) të votimit (p.sh. çdo ndryshim në shumicën e kërkuar, eliminimin e kandidatëve, etj.).
- 4 Pas çdo raundi të zgjedhjeve, kryetari i Komisionit të Verifikimit u deklaron Anëtarëve me anëtarësi të drejtpërdrejtë rezultatet zyrtare.
- 5 Sekretari i Përgjithshëm vendos fletët e votimit të mbledhura dhe të numëruara në zarfe të destinuara për këtë qëllim. Zarfet nënshkruhen nga kryetari i Komisionit të Verifikimit dhe vulosen. Sekretariati i përgjithshëm i mban këto zarfe dhe i shkatërron 90 ditë pas Asamblesë.

## VIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### NENI 30                      **ARKIVIMI I DOKUMENTEVE DHE KONFIDENCIALITETI**

- 1 Komisioni i Verifikimit dhe Komisioni i Apelit i dorëzon të gjitha dokumentet zyrtare, si dhe të gjitha dokumentet që u janë ofruar gjatë procesit zgjedhor te sekretariati i përgjithshëm, i cili është përgjegjës për arkivimin e tyre.
- 2 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit dhe të Komisionit të Apelit ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin në lidhje me çdo informacion dhe dokument të vënë në dispozicion të tyre gjatë rrjedhës së procesit zgjedhor. Ky detyrim mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar pas procesit përkatës zgjedhor. Për më

tepër, ata nuk mbajnë asnjë dokument (elektronik ose tjetër) që u është dhënë gjatë procesit zgjedhor.

---

**NENI 31 NOTERI PUBLIK**

---

Një Noter ose një person me status të barabartë ligjor me të, që njihet nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, merr pjesë në Asamble dhe harton procesverbalet Asamblesë në rast se ndryshohen Statutin ose mbahen zgjedhje.

---

**NENI 32 ÇËSHTJET E PAPANASHIKUARA NË KËTË RREGULLORE**

---

Të gjitha çështjet në lidhje me organizimin teknik dhe administrativ të Asamblesë apo me mbajtjen e zgjedhjeve, që nuk mbulohen nga kjo Rregullore ose nga Statutin dhe rregulloret e FSHF-së, rregullohen nga Komisioni i Verifikimit, vendimi i të cilit është përfundimtar.

---

**NENI 33 HYRJA NË FUQI**

---

Kjo Rregullore u miratuan në Asamblenë e mbajtur në Tiranë më datë 18.12.2020 dhe hyn në fuqi më datë 01.01.2021.

Tiranë më 18.12.2020

Për Federatën Shqiptare të Futbollit

Armand DUKA  
President

Ilir SHULKU  
Sekretari i Përgjithshëm

## SHTOJCA A

### PYETËSOR PËR KONTROLLIN E INTEGRITETIT

---

#### PJESA 1: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

---

- 1 Kontrollat e integritetit në lidhje me kandidatët dhe mbajtësit e pozicioneve zyrtare brenda FSHF-së që i nënshtrohen kontrolleve të tilla (“kandidatët ose mbajtësit”) kryhen nga organi përkatës në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe kësaj shtojce.
- 2 Kandidatët ose mbajtësit janë të detyruar të respektojnë procesin e shqyrtimit dhe vetëdeklarimit, siç përshkruhet në pjesët 2 dhe 3 më poshtë. Para procesit të kontrollit, çdo kandidat ose mbajtës duhet të japë pëlqimin e tij me shkrim për procesin në fjalë përmes një formulari të ofruar nga organi përkatës që kryen kontrollin e integritetit. Nëse nuk jepet një pëlqim i tillë me shkrim, kandidati ose mbajtësi i pozicionit do të konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e integritetit.
- 3 Kandidatët ose mbajtësit e pozicionit duhet të veprojnë me mirëbesim në çdo kohë dhe do të bashkëpunojnë plotësisht për të vërtetuar faktet përkatëse pas një njoftim të arsyeshëm. Nëse kandidati ose mbajtësi i pozicionit përkatës nuk bashkëpunon me organin kompetent për të kryer kontrollin e integritetit, kandidati ose mbajtësi i pozicionit do të konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e integritetit.
- 4 Kandidati ose mbajtësi i pozicionit konsiderohet se nuk e ka kaluar kontrollin e integritetit, nëse ai:
  - a) ka qenë objekt i dënimeve penale ose sanksioneve disiplinore nga një gjykatë kombëtare, veçanërisht nëse vepra në fjalë ka qenë çështje thelbësore dhe jo një shkelje e vogël ose sjellje e pahijshme procedurale;

- b) është shpallur fajtor dhe/ose është dënuar nga Komisioni i Etikës i FIFA-s ose ndonjë organ tjetër sportiv me një sanksion që do të vinte seriozisht në pikëpyetje realizimin e detyrës në fjalë.
- 5 Në varësi të dispozitave përkatëse në lidhje me zbulimin dhe përcjelljen e informacionit dhe të dhënave përkatëse të marra në kontekstin e kontrolleve të integritetit në përputhje me këtë shtojcë, të gjitha informacionet e tilla dhe të dhënat e lidhura me to duhet të trajtohen si rreptësisht konfidenciale nga organi që kryen kontrollin e integritetit në fjalë.

---

## **PJESA 2: PROCESI I SHQYRTIMIT**

---

- 1 Në fillim të procesit të shqyrtimit, secili kandidat ose mbajtës i një detyre duhet t'i nënshtrohet kontrollit të identifikimi ("Kontrolli i ID-së"). Në këtë kuadër, kandidati ose mbajtësi i pozicionit duhet t'i paraqesë një kopje të vlefshme të pasaportës organit përgjegjës për kryerjen e kontrollit të integritetit. Kontrolli i ID-së përfshin verifikimin/identifikimin e elementeve të mëposhtëm:
- a) emrin dhe mbiemrin;
  - b) adresën e banimit;
  - c) datën dhe vendin e lindjes;
  - d) shtetësinë.
- 2 Çdo kandidat ose mbajtës i pozicionit duhet të plotësojë pyetëSORIN që jepet në pjesën 3, më poshtë.
- 3 Organi përgjegjës për kryerjen e kontrollit të integritetit mund të kryejë kërkime të pavarura dhe/ose hetime në mënyrë që të marrë informacione të mëtejshme të rëndësishme për një kandidat ose mbajtës të një pozicioni të caktuar, i cili mund të përfshijë informacione për ndërmjetësuesit dhe palët e lidhura, mandatet, konfliktet e mundshme të interesit dhe informacione për pjesëmarrjet, si dhe procedime/hetimet civile dhe penale.

**PJESA 3: PYETËSOR**

Emri:	
Mbiemri:	
Adresa e banimit:	
Data dhe vendi i lindjes:	
Shtetësia/shtetësitë:	
Profesioni:	

- 1 A jeni dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër të qëllimshme të dënueshme, ose për ndonjë vepër që përkon me shkeljen e rregullave të sjelljes të përcaktuara në pjesën II seksioni 5 i Kodit të Etikës të FIFA-s?

Jo  Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

---

- 2 A ka vendosur ndonjëherë një organ drejtues sportiv ndonjë sanksion ose masë disiplinore, ose të ngjashme, ndaj jush në të shkuarën për veprime që përbëjnë shkelje të rregullave të sjelljes të përcaktuara në pjesën II seksioni 5 i Kodit të Etikës i FIFA-s?

Jo  Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

---

- 3 A jeni subjekt i ndonjë procedure civile, penale ose disiplinore ose hetimi penal?

Jo

Po

Nëse po, ju lutem specifikoni:

---

- 4 Unë jam plotësisht i vetëdijshëm që i nënshtrohem dispozitave të Kodit të Disiplinës dhe Etikës të FSHF-së dhe dispozitave të statuteve dhe rregulloreve të tjera të FSHF-së që mund të trajtojnë çështje të integritetit dhe unë i përmbush plotësisht këto dispozita.
- 5 Unë mbaj aktualisht pozicionet e mëposhtme në futboll: \_\_\_\_\_
- 6 Faktet dhe rrethanat e mëposhtme mund të çojnë në konflikte të mundshme interesi në lidhje me mua (në veçanti neni 23, paragrafi 9 i këtij statuti):
- 7 Vërejtje dhe vëzhgime të cilat mund të jenë me rëndësi të mundshme në kuadrin e kontrollit të integritetit:
- 
- 8 Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe bie dakord që ky pyetësor t'u vihet në dispozicion anëtarëve të organit përkatës të FSHF-së.
- 9 Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që duhet të njoftoj organin që kryen kontrollin e integritetit për çdo fakt dhe rrethanë të rëndësishme që mund të dalë pasi të ketë përfunduar kontrolli i integritetit.
- 10 Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që jam i detyruar të bashkëpunoj plotësisht për të vërtetuar faktet përkatëse në lidhje me kontrollin e integritetit të cilit po i nënshtrohem. Në veçanti, pajtohem me kërke-



sat për çdo dokument, informacion ose ndonjë material tjetër të çfarëdo natyre të mbajtur nga unë. Përveç kësaj, unë do të veproj në përputhje me kërkesën për të vënë në dispozicion dhe ofruar dokumente, informacione ose çdo material tjetër të çfarëdo natyre që nuk mbahet nga unë, por që unë kam të drejtë të marr.

- 11 Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që organi që kryen kontrollin e integritetit gjithashtu mund të kërkojë informacion mbi sanksionet e mundshme (pyetjet 1 dhe 2 më sipër) në mënyrë të drejtpërdrejtë nga FIFA ose konfederata përkatëse si dhe nga institucione të tjera, të tilla si Gjykata e Arbitrazhit për Sportin në Lozanë, Zvicër, ose Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Në këtë drejtim, unë i liroj institucionet përkatëse nga çdo detyrim konfidencialiteti në lidhje me informacionin në fjalë.
  
- 12 Unë jam plotësisht i vetëdijshëm dhe konfirmoj që organi që kryen kontrollin e integritetit mund të mbledhë informacione të mëtejshme për mua në përputhje me pjesën 2, paragrafi 3 i kësaj shtojce.

---

(data dhe vendi)

---

(nënshkrimi)

## SHTOJCA B

# RREGULLORE E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT (FSHF)

### PËRKUFIZIME

Kurdoherë që është e nevojshme, terminologjia e përdorur në Kjo Rregullore i referohet termave të përcaktuar në seksionin e Përkufizimeve në Statutin e FSHF.

NB: Termat të cilat i referohen personit fizik janë të zbatueshme për të dyja gjinitë. Çdo term në njëjës nënkupton dhe zbatohet edhe në shumës dhe anasjelltas.

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### NENI 1 FUSHA E ZBATIMI

- 1 Kjo Rregullore është e zbatueshme për Asamblenë e Përgjithshme të FSHF dhe për zgjedhjet e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe komisioneve të pavarura siç përcaktohet në Statutin e FSHF.
- 2 Kjo Rregullore është gjithashtu e zbatueshme për zgjedhjet e anëtarëve të organeve përkatëse të shoqatave rajonale dhe shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin, nëse Statuti i tyre e parashikon në mënyrë specifike këtë. Statutet e shoqatave rajonale dhe shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin përcaktojnë fushën e saktë të zbatimit të kësaj rregullore dhe veçanërisht nëse Komisioni i Verifikimit luan rolin e mbikëqyrësit të procesit zgjedhor përkatës.

---

**NENI 2                    PARIMET DHE DETYRIMET**

---

- 1    Kjo Rregullore synon të sigurojë një zhvillim të qetë dhe korrekt të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së duke mbrojtur detyrimet e të gjitha palëve të përfshira.
- 2    Parimet e përgjithshme të qeverisjes së mirë, të tilla si ndarja e pushteteve, pavarësia, transparencja dhe detyrimi për të shmangur situatat e konfliktit të interesit do të respektohen pa përjashtim përgjatë gjithë procesit zgjedhor ose të Asamblesë.
- 3    Ndikimi i padrejtë nga palët e treta në procesin zgjedhor është i ndaluar. FSHF informon menjëherë FIFA dhe UEFA për çdo ndikim të padrejtë nga palët e treta në procesin zgjedhor.
- 4    FSHF siguron që çdo proces zgjedhor i organeve në varësi të saj është në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore, me Statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s.
- 5    FSHF, të paktën 30 ditë para datës së zgjedhjeve përkatëse, informon FIFA dhe UEFA për natyrën e zgjedhjeve që priten të mbahen (p.sh. numrin e anëtarëve që do të zgjidhen, kohëzgjatjen e mandateve, arsyen e zhvillimit të zgjedhjeve, etj.) dhe siguron për FIFA dhe UEFA një kopje të Rregullores në fuqi dhe, nëse është e zbatueshme, çdo rregullore dhe udhëzim tjetër zgjedhor.
- 6    Në qoftë se nuk parashikohet ndryshe në Statutin dhe rregulloret e FSHF, anëtarët e organeve përkatëse të FSHF do të vijojnë të ushtrojnë funksionet e tyre deri në përfundimin e procesit zgjedhor. Mandatet përkatëse të organeve të sapo zgjedhura fillojnë pas përfundimit të Asamblesë nëpërmjet së cilës ata zgjidhen.

## II. PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

### NENI 3 PËRFAQËSIMI

- 1 Shoqatat Rajonale sigurojnë përfaqësimin e duhur midis anëtarëve të tyre duke shpërndarë numrin e delegatëve që iu atribuohen atyre nga Komisioni i Verifikimit në 4 (katër) pjesë duke përdorur metodën e mëposhtme:
  - Një (1) delegat për çdo 1000 lojtarë të licencuar që marrin pjesë në garat rajonale të të gjitha niveleve;
  - Një (1) delegat për çdo dy (2) klube që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Dytë;
  - Një (1) delegat për çdo tre (3) klube që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Tretë;
  - Një (1) delegat për çdo dy (2) klube të femrave që marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar të Femrave;

Në rast se Komisioni i Verifikimit e korrekton numrin e delegatëve për shoqatat rajonale bazuar në Nenin 28 paragrafi 2 të Statutit, atëherë Komisioni i Verifikimit do të përshtatë kriteret e mësipërme duke ruajtur raportin midis 4 (katër) kriteret.
- 2 Shpenzimet e udhëtimit të delegatëve dhe/ose shpenzimet e akomodimit mbulohen nga Anëtari me anëtarësi të drejtpërdrejtë.

## III. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E ASAMBLESË

### NENI 4 DREJTUESI I ASAMBLESË

- 1 Asambleja drejtohet nga Presidenti i FSHF. Në rast të mungesës së tij, Asambleja drejtohet nga zv/Presidenti i parë dhe në mungesë të tij nga zv/Presidenti i dytë. Nëse edhe ky i fundit nuk mund të marrë

pjesë, Asambleja cakton një anëtar të Komitetit Ekzekutiv si Drejtues. Gjatë zgjedhjes së Presidentit dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv, Asamblenë e kryeson Kryetari i Komisionit të Verifikimit.

- 2 Drejtuesi i Asamblesë siguron që të ndiqen rregullat e procedurave. Ai është kompetent për çeljen dhe mbylljen e punimeve të Asamblesë. Ai procedon sipas rendit të ditës dhe i jep fjalën delegatëve dhe/ose të ftuarve.
- 3 Drejtuesi mban rregull në Asamble. Ai mund të marrë masat e mëposhtme kundrejt pjesëmarrësve që ndërpresin procedurat:
  - a) kërkon vendosjen e qetësisë;
  - b) qorton;
  - c) përjashton nga Asambleja.

---

## **NENI 5                    SEKRETARIATI**

---

Sekretari i Përgjithshëm dhe vëzhguesit përbëjnë Sekretariatën e Asamblesë.

---

## **NENI 6                    RENDI I DITËS**

---

- 1 Rendi i ditës miratohet në fillim të Asamblesë.
- 2 Rendi i ditës i një Asambleje të Zakonshme mund të ndryshohet në çdo moment gjatë Asamblesë, me kusht që dy të tretat e delegatëve të pranishëm në Asamble, dhe me të drejtë vote, të bien dakord për këtë mocion. Rendi i ditës i një Asambleje të Jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet.
- 3 Asambleja nuk mund të marrë në konsideratë një propozim për të ndryshuar Statutin nëse nuk përfshihet si pikë diskutimi në rendin e ditës të dërguar me njoftimin e Asamblesë.

---

**NENI 7**                    **DISKUTIMI**

---

- 1 Çdo pikë e rendit të ditës prezantohet me një raport të shkurtër:
  - a) nga Drejtuesi ose një anëtar i Komitetit Ekzekutiv;
  - b) nga një përfaqësues i caktuar për këtë qëllim nga një Komision;
  - c) nga Anëtari me anëtarësim të drejtpërdrejtë, i cili e ka përfshirë çështjen në fjalë në rendin e ditës.
- 2 Kjo pikë hapet më pas për diskutim të përgjithshëm.

---

**NENI 8**                    **LEJA PËR TË MARRË FJALËN**

---

- 1 Delegatëve u jepet leja për të marrë fjalën sipas radhës që është bërë kërkesa. Një folës nuk mund ta marrë fjalën nëse nuk i është dhënë leja për ta bërë këtë. Folësi flet nga vendi i përcaktuar për këtë qëllim.
- 2 Një folës mund t'i jepet fjala për herë të dytë për të njëjtën çështje vetë kur të gjithë Delegatët e tjerë që kanë kërkuar të marrin fjalën kanë pasur një mundësi për të folur për çështjen në fjalë.
- 3 Drejtuesi mund të caktojë një afat kohor për folësit.

---

**NENI 9**                    **MOCION PËR ÇËSHTJE PROCEDURALE**

---

- 1 Një mocion për çështje procedurale trajtohet menjëherë. Çdo diskutim tjetër pezullohet menjëherë.
- 2 Nëse miratohet një mocion për çështje procedurale, u jepet fjala vetëm Delegatëve, të cilët e kanë kërkuar bëjnë mocionin para votimit.
- 3 Drejtuesi vendos kur do të mbyllë diskutimin, përveç nëse më shumë se gjysma e Anëtarëve me anëtarësi të drejtpërdrejtë të pranishëm dhe me të drejtë vote, votojnë për të kundërtën.

---

**NENI 10 MOCIONET, MOCIONET PËR NDRYSHIMIN E PIKAVE TË RENDIT DHE MOCIONET PËR FSHIRJEN E PIKAVE TË RENDIT**

---

Të gjitha mocionet, mocionet për ndryshimin dhe fshirjen e pikave të rendit të ditës bëhen me shkrim.

---

**NENI 11 VOTIMI**

---

- 1 Votimi është i hapur, përveç nëse vendoset ndryshe nga Asambleja.
- 2 Votimi bëhet duke ngritur dorën (kartën e votimit) ose me anë të një numërimi elektronik.
- 3 Nëse votimi bëhet me apel, Sekretariati i Asamblesë numëron votat dhe vërteton rezultatin.
- 4 Askush nuk detyrohet të votojë.
- 5 Para çdo votimi, Drejtuesi, ose një person i caktuar prej tij për këtë qëllim, lexon propozimin dhe i shpjegon Asamblesë procedurën e votimit.
- 6 Propozimet normalisht votohen sipas radhës në të cilën vendosen në diskutim.
- 7 Një propozim për të ndryshuar një amendim të propozuar votohet përpara këtij amendimi. Një amendim i propozuar votohet përpara propozimit fillestar.
- 8 Propozimet që nuk kundërshtohen do të konsiderohen të miratuara.
- 9 Drejtuesi bindet dhe shpall rezultatin e votimit, nëse është e nevojshme pasi Sekretariati i Asamblesë vërteton rezultatet.
- 10 Askujt nuk mund t'i jepet fjala gjatë votimit ose derisa të shpallet rezultati i një vote.

---

**NENI 12 MBAJTJA E SEANCËS NË MËNYRË PUBLIKE**

---

- 1 Komiteti Ekzekutiv mund të vendosë ta mbajë Asamblenë publikisht.
- 2 Media mund të ftohen të marrin pjesë në Asamble.

---

**NENI 13 RRETHANA TË JASHTËZAKONSHME**

---

- 1 Në rast të forcave madhore ose rrethanave të jashtëzakonshme, Komiteti Ekzekutiv mund të vendosë ta mbajë Asamblenë përmes video-konferencës ose ndonjë mjeti tjetër të ngjashëm të komunikimit që lejon që delegatët të shohin dhe dëgjojnë njëri-tjetrin njëkohësisht. Në këtë rast, Komisioni i Verifikimit zbaton një sistem elektronik të votimit (i) duke garantuar që, kur është e zbatueshme, të respektohet fshehtësia e votës dhe e zgjedhjeve dhe (ii) të zëvendësojë rregullat për fletët e votimit, siç përcaktohet në nenin 22 ff të Rregullores.
- 2 Nënshkrimet elektronike pranohen gjatë Asambleve të mbajtura virtualisht.

#### IV. KOMISIONI I VERIFIKIMIT

---

**NENI 14 PARIMET E PËRGJITHSHME**

---

- 1 Komisioni i Verifikimit:
  - a) vendos numrin e delegatëve të caktuar për Futbollin Profesionist, shoqatat rajonale dhe shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin;
  - b) mbikëqyr Asamblenë;
  - c) organizon dhe mbikëqyr procesin zgjedhor; dhe



- d) kryen kontrole të integritetit, në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit dhe kësaj Rregulloreje.
- 2 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë organi tjetër të FSHF dhe nuk mund të mbajnë ndonjë pozicion ekzekutiv në ndonjë organ qeveritar. Anëtarët e Komisionit të Verifikimit nuk mund të jenë kandidatë për ndonjë nga pozicionet që duhet të plotësohen brenda FSHF për sa kohë që ata janë ende nën mandat si anëtarë.
- 3 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit tërhiqen menjëherë nga çështja në proces dhe kufizohen nga marrja e ndonjë vendimi nëse:
  - a) ata janë pjesëtar të rrethit të ngushtë familjar i njërit prej kandidatëve që garojnë për ndonjë nga pozicionet që do të plotësohen;
  - b) kur ekziston një rrezik ose mundësi e një konflikti interesi siç përcaktohet në Kodin Disiplinës dhe të Etikës të FSHF.
- 4 Në rast se një anëtar i Komisionit të Verifikimit nuk plotëson ndonjë nga kërkesat e mësipërme dhe/ose duhet të tërhiqet nga pozicioni si anëtar i Komisionit të Verifikimit për ndonjë arsye, ai zëvendësohet në përputhje me dispozitat e parashikuara në Nenin 4 paragrafi 3 i këtyre Rregulloreve.
- 5 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit emërohen nga Asambleja, në përputhje me dispozitat e Statutit të FSHF-së, për një mandat prej 2 (dy) vjetësh.
- 6 Asnjë anëtar i Komisionit të Verifikimit nuk do të shërbejë për më shumë se dy mandate, qoftë dy mandate të njëpasnjëshme ose jo.
- 7 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit veprojnë me mirëbesim në çdo kohë dhe veprojnë me paanshmëri të theksuar kur kryejnë detyrat e tyre.

---

**NENI 15**            **PËRBËRJA**

---

- 1    Komisioni i Verifikimit ka përbërjen e mëposhtme:
  - a)   një kryetar; dhe
  - b)   dy anëtarë të zakonshëm, njëri prej të cilëve emërohet nënkryetar.
- 2    Asambleja emëron gjithashtu numrin e duhur të zëvendësuesve.
- 3    Nëse kryetari mungon ose nuk është i disponueshëm, zëvendës-kryetari vepron në cilësi të tij, dhe nëse edhe ai mungon ose nuk është i disponueshëm, atëherë një anëtar i zakonshëm vepron si zëvendësues në cilësinë e tyre. Çdo anëtar i zakonshëm që mungon ose është i padisponueshëm do të zëvendësohet nga një zëvendësues.
- 4    Kryetari emëron një nga anëtarët e Komisionit të Verifikimit si sekretar, i cili do të jetë përgjegjës për çështjet përkatëse logjistike dhe administrative. Ai mund të thërrasë sekretarinë e përgjithshme për ta ndihmuar atë në përmbushjen e detyrave të tij.
- 5    Kryetari i Komisionit të Verifikimit duhet të jetë i kualifikuar për të ushtruar profesionin e avokatit.
- 6    Çdo anëtar i Komisionit të Verifikimit nënshkruan një deklaratë se ata vetë i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Nenin 32 paragrafi 8 i Statutit, kërkesat e pavarësisë të përcaktuara në Nenin 62 paragrafi 3 të Statutit dhe kërkesat e integritetit të përcaktuara në Nenin 62 paragrafi 4 të këtij Statuti.

---

**NENI 16**            **DETYRAT E KOMISIONIT TË VERIFIKIMIT**

---

Komisioni i Verifikimit është përgjegjës për caktimin e delegatëve të Futbollit Profesionist, shoqatave rajonale dhe palëve të interesuara për futbollin, mbikëqyrjen e Asamblesë, organizimin dhe mbikëqyrjen e

zgjedhjeve që do të zhvillohen gjatë Asamblesë. Në veçanti, Komisioni i Verifikimit është përgjegjës për:

- a) zbatimin në mënyrë rigorozë të Statuteve dhe rregulloreve të FSHF, si edhe të kësaj Rregulloreje;
- b) FSHF siguron që çdo rregullore dhe udhëzim zgjedhor i organeve në varësi të saj është në përputhje me dispozitat e Statuteve dhe këtyre Rregulloreve si dhe me Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-s.
- c) zbatimin me përpikëri të afateve ligjore të zgjedhjeve;
- d) sigurimin e informacionit për anëtarët me anëtarësim të drejtpërdrejtë, si dhe për autoritetet përkatëse qeveritare (kur është e nevojshme), mediat dhe publikun, sidomos duke mbajtur një konferencë mediatike (kur është e nevojshme);
- e) kur është e nevojshme, menaxhimin e marrëdhënieve me autoritetet përkatëse qeveritare;
- f) procedurën e kandidimit (fillimi, shpërndarja e informacionit, vlerësimi, publikimi i listës zyrtare, etj.);
- j) përcaktimin dhe rregullimin e numrit të delegatëve të caktuar për Futbollin Profesional, federatat rajonale dhe palët e interesuara për futbollin, të ndihmuar nga sekretariati i përgjithshëm, në përputhje me Statutin dhe Kjo Rregullore;
- h) verifikimin e identitetit të votuesve (delegatëve) dhe kompetencat e tyre të përfaqësimit;
- i) monitorimin e procedurave zgjedhore dhe të votimit, duke përfshirë marrjen e çdo vendimi në lidhje me vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e fletëve të votimit, miratimin e një vendimi përfundimtar për çdo çështje që ka të bëjë me procedurën zgjedhore gjatë Asamblesë Zgjedhore dhe vërtetimin e rezultateve zyrtare;
- j) kryerjen e kontrolleve në lidhje me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes, pavarësisë dhe kërkesave të integritetit të përcaktuara në Statute.

- k) çdo dhe të gjitha detyrat e tjera për të siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

---

## **NENI 17 MBLEDHJET, KUORUMI DHE VENDIMET**

---

- 1 Kryetari thërret mbledhjet e Komisionit të Verifikimit. Vetëm një Komisioni i Verifikimit i organizuar në mënyrën e duhur ka autoritetin për të gjykuar dhe për të marrë vendime.
- 2 Komisioni i Verifikimit nuk mund të mbajë një mbledhje të vlefshme përveç nëse një shumicë (më shumë se 50%) e anëtarëve të tij është e pranishme.
- 3 Komisioni i Verifikimit do të marrë vendimet e tij me shumicën (më shumë se 50%) të votave të vlefshme të hedhura. Abstenimet nuk lejohet. Nuk lejohet votimi me prokurë ose me korrespondencë. Në rast barazimi të votave, kryetari gëzon të drejtën e votës vendimtare.
- 4 Vendimet e marra regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga kryetari dhe nga sekretari i Komisionit të Verifikimit.

## **V. KANDIDATURAT**

---

### **NENI 18 KRITERET E PËRZGJEDHJES**

---

- 1 Kriteret e përzgjedhjes për pozicionet që duhet të plotësohen brenda organeve përkatëse të FSHF janë të parashikuara në dispozitat përkatëse të Statuteve.
- 2 Komisioni i Verifikimit nuk do të vendosë ndonjë kriter të përzgjedhjes që nuk parashikohet në Statutin ose ndonjë kriter tjetër zyrtar që nuk parashikohet në Statute ose në këtë Rregullore. Komisioni i Verifikimit do të kërkojë vetëm dokumentet që ndihmojnë të përcaktohet nëse kriteret përkatëse të përzgjedhjes janë përmbushur.

- 3 Komisioni i Verifikimit publikon listën e plotë të kriterëve të përzgjedhjes (duke iu referuar dispozitave përkatëse të Statuteve, si dhe dokumenteve që do të paraqiten për secilin nga pozicionet brenda afateve të parashikuara në Statutin e FSHF-së.

---

**NENI 19                    PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I KANDIDATURAVE  
PËR NË KOMITETIN EKZEKUTIV**

---

- 1 Asnjë tarifë ose pagesë e çfarëdo lloji nuk do të kërkohet nga asnjë prej kandidatëve në asnjë moment gjatë gjithë procedurës zgjedhore, përveç rasteve kur janë miratuar më parë nga Asambleja. Në çdo rast, çdo tarifë ose pagesë e rënë dakord do të jetë në nivele të arsyeshme dhe do të shërbejë vetëm për të mbuluar kostot e shpenzimeve përkatëse administrative.
- 2 Kandidaturat për cilindo nga pozicionet e Komitetit Ekzekutiv dërgohen me postë të regjistruar, me postë elektronike të konfirmuar nga marrësi, ose dorëzohen dorazi në këmbim të konfirmimit të marrjes, në sekretarinë e përgjithshme të paktën 20 ditë para organizimit të Asamblesë zgjedhore. Kandidaturat e marra nga sekretariati i përgjithshëm i dërgohen menjëherë sekretarit të Komisionit të Verifikimit për kontrollet përkatëse të përzgjedhjes dhe integritetit të cilat do të kryhen sipas Shtojcës A të Statutit.
- 3 Brenda 3 (tre) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e kandidaturave, Komisioni i Verifikimit informon me shkrim ata kandidatë që nuk kanë arritur të japin të gjitha dokumentet përkatëse në mbështetje të kandidaturave të tyre dhe u jep atyre dy (2) ditë të tjera për të përfunduar aplikimet. Nëse kandidatët përkatës nuk arrijnë të plotësojnë aplikimet brenda afatit të përcaktuar, kandidaturat e tyre deklarohen të pavlefshme. Ky paragraf nuk zbatohet për shprehjet e mbështetjes të parashikuara në Nenin 32 paragrafi 4 i Statutit, të cilat duhet të paraqiten brenda afatit të fundit për dorëzimin e kandidaturave për Komitetin Ekzekutiv.

- 4 Kandidaturat për Komitetin Ekzekutiv shqyrtohen nga Komisioni i Verifikimit brenda pesë (5) ditëve nga marrja e plotë të aplikimit dhe kandidatët informohen për vendimin e Komisionit të Verifikimit brenda kësaj periudhe.

---

**NENI 20                    PROCEDURA E ANKIMIT PËR KANDIDATËT PËR  
NË KOMITETIN EKZEKUTIV**

---

- 1 Ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Verifikimit mund të paraqiten vetëm në Komisionin e Apelit, duke përjashtuar kështu mundësinë e apelimit të vendimeve të përmendura para çdo organi tjetër, veçanërisht një organi qeveritar.
- 2 Çdo ankim, i arsyetuar dërgohet me postë të regjistruar, ose dorëzohet në këmbim të konfirmimit të marrjes, në Sekretariatin e Përgjithshëm brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e vendimit të Komisionit të Verifikimit. Ankimet e marra nga sekretariati i përgjithshëm u dërgohen menjëherë anëtarëve të Komisionit të Apelit.
- 3 Komisioni i Apelit mund të vendosë të pranojë prova dhe dokumente të reja që nuk janë ofruar nga kandidati përkatës së bashku me kandidaturën fillestare.
- 4 Ankimi shqyrtohet nga Komisioni i Apelit brenda dy ditëve nga marrja e tyre dhe u komunikohen aplikaknteve brenda kësaj periudhe.
- 5 Ankimet pranohen, rrëzohen ose deklarohen të papranueshme nga Komisioni i Apelit. Në rast se ankimi miratohet, Komisioni i Apelit merr një vendim duke zëvendësuar vendimin e Komisionit të Verifikimit.
- 6 Vendimet e Komisionit të Apelit janë përfundimtare dhe të detyrueshme për t`u zbatuar.

---

**NENI 21            PROCEDURA PËR KANDIDATËT PËR ORGANET  
E TJERA TË FSHF-SË**


---

- 1 Kandidaturat për pozicionet e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve të pavarura, (d.m.th. Komisioni i Auditit, Komisioni i Verifikimit dhe organet gjyqësore) dërgohen nga Komiteti Ekzekutiv pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të paktën 20 (njëzet) ditë përpara Asamblesë përkatëse zgjedhore. Kandidaturat e marra nga Sekretariati i Përgjithshëm i dërgohen menjëherë Komisionit të Verifikimit për të kryer kontrollet përkatëse të përzgjedhjes, pavarësisë dhe integritetit (kur është e nevojshme).
- 2 Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kandidaturave, Komisioni i Verifikimit i konfirmon sekretarisë së përgjithshme nëse janë përmbushur kërkesat për pozicionet përkatëse. Në rast se një ose më shumë kandidatë nuk mund të konsiderohen të përshtatshëm, Komiteti Ekzekutiv propozon kandidatë shtesë për pozicionet përkatëse.

---

**NENI 22            LISTA ZYRTARE E KANDIDATËVE**


---

Lista zyrtare e kandidatëve bëhet publike gjithashtu në faqen e internetit të FSHF-së dhe, kur është e nevojshme, u dërgohet autoriteteve përkatëse geveritare për informacion.

**IV. PROCEDURA E VOTIMIT**


---

**NENI 23            FLETËT E VOTIMIT**


---

- 1 Sekretariati i përgjithshëm prodhon fletët e votimit nën mbikëqyrjen e Komisionit të Verifikimit. Fletët e votimit printohen të qarta dhe

të lexueshme. Fletët e votimit mund të jenë në formën e një liste të kandidatëve për zgjedhjet që zhvillohen në bllok.

- 2 Fletët e votimit janë me ngjyra të ndryshme për secilin raund të zgjedhjeve.

---

#### **NENI 24 KUTIA E VOTIMIT**

---

- 1 Para fillimit të procedurës së votimit, kutia e votimit, e cila është transparente nëse është e mundur, hapet dhe u paraqitet delegatëve të Asamblesë. Kutia e votimit mbyllet dhe vendoset në një vend të dukshëm afër anëtarëve të Komisionit të Verifikimit.
- 2 Gjatë gjithë procesit të votimit, kutia monitorohet nga një prej anëtarëve të Komisionit të Verifikimit.

---

#### **NENI 25 HEDHJA E VOTAVE**

---

- 1 Para se delegatëve t'u kërkohet të votojnë, kryetari i Komisionit të Verifikimit shpjegon hollësisht procedurën zgjedhore (kutinë e votimit, fletët e votimit, fletët e vlefshme dhe të pavlefshme të votimit, numërimin, shumicat e kërkuara, rezultatet, etj) dhe iu referohet dispozitave statutore përkatëse.
- 2 Zgjedhjet e Presidentit dhe anëtarëve të mbetur të Komitetit Ekzekutiv zhvillohen si më poshtë:
  - a) Kryetari i Komisionit të Verifikimit thërret me radhë secilin delegat të pranishëm dhe me të drejtë vote që të shkojë në pjesën e përparme të sallës së Asamblesë ku zhvillohen zgjedhjet.
  - b) Pasi të thirret, i deleguari përkatës shkon në pjesën e përparme të sallës së Asamblesë dhe, pasi nënshkruan vërtetimin e fletës së votimit, merr fletën e votimit.



- c) Delegati më pas plotëson fletën e tij të votimit në kabinën e votimit të caktuar për këtë qëllim. Kabina e votimit vendoset në një vend të dukshëm, por gjithsesi lejon që i deleguari të votojë në mënyrë të fshehtë. Asnjë celular, kamerë ose ndonjë pajisje tjetër regjistruese nuk lejohet në kabinën e votimit; dhe
  - d) Më pas delegati depoziton fletën e votimit në kutinë e votimit, nënshkruan regjistrin zgjedhor dhe kthehet në vendin e tij.
- 3 Zgjedhjet e kandidatëve të organeve të tjera të FSHF-së zhvillohen si më poshtë: Delegatët qëndrojnë në vendet e tyre dhe hedhin votën duke përdorur një kuti votimi të lëvizshme që kalohet nga një vend në tjetrin nga një nga kontrollorët dhe mbikëqyret nga afër nga një anëtar i Komisionit të Verifikimit.
  - 4 Procedura e numërimit fillon sapo të gjithë delegatët të kenë depozituar fletët e votimit në kutinë e votimit ose në kutinë e lëvizshme të votimit. Një anëtar i Komisionit të Verifikimit hap kutinë e votimit/kutinë e lëvizshme të votimit dhe nxjerr fletët e votimit para të gjithë delegatëve.
  - 5 Më pas fillon numërim.

## VII. NUMËRIMI

### NENI 26 PARIMET E PËRGJITHSHME

- 1 Vetëm anëtarët e Sekretariatit të Asamblesë dhe të Komisionit të Verifikimit marrin pjesë në numërimin e fletëve të votimit. Të gjitha veprimet (hapja e kutisë së votimit, numërimi i fletëve të votimit, numërimi i votave, etj.) kryhen në mënyrë të tillë që të ndiqet qartë nga të gjithë delegatët e Asamblesë.
- 2 Në rast të një mosmarrëveshjeje në lidhje me vlefshmërinë ose pavlefshmërinë e një fletë votimi ose të një vote, hartimin e procesverbalit, deklarimin e rezultateve ose ndonjë çështje tjetër në

lidhje me procedurën e numërimit, vendimi i Komisionit të Verifikimit është përfundimtar.

---

**NENI 27 FLETËT E PAVLEFSHME TË VOTIMIT**

---

- 1 Fletët e votimit si më poshtë konsiderohen të pavlefshme:
  - a) fletët e votimit që nuk përmbajnë shenjat dalluese zyrtare të përcaktuara nga Komisioni i Verifikimit;
  - b) fletët e votimit që përmbajnë ndonjë fjalë tjetër përveç emrave të kandidatëve;
  - c) fletët e votimit të pallexueshme ose të dëmtuara;
  - d) fletët e votimit që mbajnë shenja identifikuese.
- 2 Kryetari i Komisionit të Verifikimit shkruan në pjesën e pasme të çdo flete votimi të pavlefshme arsyen e pavlefshmërisë së fletës dhe e konfirmon me një nënshkrim.

---

**NENI 28 GABIMET DREJTSHKRIMORE**

---

Gabimet drejtshkrimore shkaktojnë pavlefshmërinë e një flete të vetme votimi nëse për shkak të tyre, nuk është e mundur të identifikohet ndonjë nga kandidatët zyrtarë.

---

**NENI 29 NUMËRIMI DHE SHPALLJA E REZULTATIT**

---

- 1 Pasi të jetë hapur kutia e votimit, anëtarët e Komisionit të Verifikimit do të numërojnë numrin e fletëve të votimit dhe do të verifikojnë vlefshmërinë e tyre. Nëse numri i fletëve të votimit është i barabartë ose më i vogël se numri i fletëve të votimit të lëshuara, votimi do të konsiderohet i vlefshëm. Nëse tejkalohej numri i fletëve të votimit të

lëshuara, votimi shpallet i pavlefshëm dhe do të përsëritet menjëherë në përputhje me procedurën e përshkruar më sipër.

- 2 Pasi të jetë verifikuar numri i fletëve të votimit, anëtarët e Sekretariatit të Asamblesë dhe të Komisionit të Verifikimit vazhdojnë të numërojnë numrin e votave të hedhura për secilin kandidat ose listë.
- 3 Nëse kërkohet një raund i dytë (ose pasardhës) votimi, procedura e votimit përsëritet në përputhje me nenet e mësipërme. Delegatët gjithashtu duhet të informohen për dispozitat ligjore që zbatohen për raundet e dyta (dhe pasuese) të votimit (p.sh. çdo ndryshim në shumicën e kërkuar, eliminimin e kandidatëve, etj.).
- 4 Pas çdo raundi të zgjedhjeve, kryetari i Komisionit të Verifikimit u deklaron Anëtarëve me anëtarësi të drejtpërdrejtë rezultatet zyrtare.
- 5 Sekretari i Përgjithshëm vendos fletët e votimit të mbledhura dhe të numëruara në zarfe të destinuara për këtë qëllim. Zarfet nënshkruhen nga kryetari i Komisionit të Verifikimit dhe vulosen. Sekretariati i përgjithshëm i mban këto zarfe dhe i shkatërron 90 ditë pas Asamblesë.

## VIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### **NENI 30                    ARKIVIMI I DOKUMENTEVE DHE KONFIDENCIALITETI**

- 1 Komisioni i Verifikimit dhe Komisioni i Apelit i dorëzon të gjitha dokumentet zyrtare, si dhe të gjitha dokumentet që u janë ofruar gjatë procesit zgjedhor te sekretariati i përgjithshëm, i cili është përgjegjës për arkivimin e tyre.
- 2 Anëtarët e Komisionit të Verifikimit dhe të Komisionit të Apelit ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin në lidhje me çdo informacion dhe dokument të vënë në dispozicion të tyre gjatë rrjedhës së procesit zgjedhor. Ky detyrim mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar pas procesit përkatës zgjedhor. Për më tepër, ata nuk mbajnë asnjë

dokument (elektronik ose tjetër) që u është dhënë gjatë procesit zgjedhor.

---

**NENI 31 NOTERI PUBLIK**

---

Një Noter ose një person me status të barabartë ligjor me të, që njihet nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë, merr pjesë në Asamble dhe harton procesverbalet Asamblesë në rast se ndryshohen Statutin ose mbahen zgjedhje.

---

**NENI 32 ÇËSHTJET E PAPANASHIKUARA NË KËTË RREGULLORE**

---

- 1 Të gjitha çështjet në lidhje me organizimin teknik dhe administrativ të Asamblesë që nuk mbulohen nga Kjo Rregullore ose nga Statutin dhe rregulloret e FSHF-së, rregullohen nga Komisioni i Verifikimit, vendimi i të cilit është përfundimtar.

---

**NENI 33 HYRJA NË FUQI**

---

Kjo Rregullore u miratuan në Asamblenë e mbajtur në Tiranë më datë 18.12.2020 dhe hyn në fuqi më datë 01.01.2021.

Tiranë më 18.12.2020

**Për Federatën Shqiptare të Futbollit**

**Armand DUKA**  
President

**Ilir SHULKU**  
Sekretari i Përgjithshëm